
RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

"RIKUALIFIKIMI I BLOKUT TE TREGU ÇAM"

Ky raport është përgatitur pas hartimit të projektit të zbatimit duke marrë parasysh të gjithë dokumentacionin e dorëzuar dhe në përputhje me ligjin Nr. 10440, dt. 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Përgatiti:

EKSPERTI VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

ENTE LA ÇANO

Permbajtja

1 HYRJE	4
1.1 Parimet e Hartimit te VNM-së	5
1.2 Qëllimi i kryerjes së raportit të VNM-së	5
1.3 Kuadri ligjor vendor dhe ndërkombëtar, politikat kryesore	7
1.3.1 Kuadri ligjor kombëtar	8
1.3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar	9
1.3.3 Kuadri ligjor European	9
2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES NE ZONEN E PROJEKTIT.....	11
2.1 Mbulesa bimore e zonës	11
2.1.1 Zonat e mbrojtura	11
2.1.2 Flora	11
2.1.3 Fauna	12
2.2 Mjedisi fizik	13
2.2.1 Gjeologjia	14
2.2.2 Klima	16
2.2.3 Temperatura e ajrit	16
2.2.4 Reshjet atmosferike	17
2.2.5 Cilesia e ajrit	20
2.2.6 Biodiversiteti	22
2.2.7 Zhurmat (Ndotja Akustike)	24
3 INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE	26
3.1 Hidrologjia	26
3.1.1 Analiza hidrogeologjike	27
3.1.2 Analiza hidrografike	28
3.1.3 Fluksi i ujit ne verbatim rajonal	28
3.1.4 Fluksi i ujit	28
3.1.5 Burimet ujore sipërfaqesore	29
3.1.6 Burimet ujore nëntokësore	29
4 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME	31
4.1 Metodologjia per identifikimin dhe analizen e ndikimeve	31
4.2 Ndikimi gjate fazes se zbatimit/ndertimit	33
4.2.1 Ndikimi social	33
4.2.2 Ndikimi fizik me ndryshime ne topografikne lokale	33
4.2.3 Demtimi i habitateve dhe biodiversitetit	34
4.2.4 Ndikimi negativ ne mjedis	34
4.2.5 Ndikimet e mundshme ne peisazh dhe anen vizuale	35

4.2.6 Presioni mbi burimet (lendet e para) ekzistuese	36
4.2.7 Gjenerimi i zhurmave dhe vibrimeve	36
4.2.8 Trafiku dhe emertimet qe lidhen me te	37
4.2.9 Siguria dhe shendetet ne pune	38
4.2.10 Aksidentet	39
4.3 Ndikimi gjate fazes se funksionimit	40
4.3.1 Ndikimet sociale	40
4.3.2 Permiresimi i pamjes vizuale dhe rritja e vleres se pasurise se paluajtshme	40
4.3.3 Menaxhimi i papershtatshem i mbetjeve	40
4.3.4 Gjenerimi i zhurmave	40
5 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS	41
5.1 Shkarkimet e gazrave dhe pluhurave	41
5.2 Mbetjet e ngurta	43
5.3 Shkarkimet ne ujerat sipërfaqesore dhe nentokesore	45
5.3.1 Ujërat sipërfaqësore	45
5.3.2 Ujërat nentokesore	45
5.4 Menaxhimi i mbeturinave dhe ndotja e mjedisit	46
5.4.1 Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	47
5.4.2 Impakti mbi tokë	47
5.4.2.1 Impakti gjate fazes se ndertimit	47
5.4.3 Ndikimi në nivelin e zhurmës	47
5.4.4 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve	48
6 INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA	48
7 TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV	49
8 MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR	50
8.1 Mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme	50
8.2 Masat rehabilituese	51
8.3 Kostot financiare per rehabilitim	54
9 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN	54
9.1 Marreveshjet institucionale: Strukturat dhe pergjegjesite	54
9.2 Monitorimi dhe raportimi	55
9.3 Mekanizmi i zgjedhjes se ankesave.....	55
10 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN	57
11 PËRFUNDIME	58

1. HYRJE

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin Shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së veprës, duke përfshirë kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujorë dhe biologjike, kulturën dhe kushtet social-ekonomike të zonës. Metoda e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e list-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundëshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me një sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Në këtë studim jepen në detaje:

- Mundësitë për teknologji të pastër;
- Rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- Shqyrtimi i alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Vlerësimi cilësor me pike të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozimeve të masave zbutëse të ndikimit të projektit.

Ky projekt në bazë të Ligjit 10440 datë 07.07.2011, shtojca II, pika 10 i nënshtrohet Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Ai synon parashikimin e efekteve kryesore të pritshme në mjedis nga ky investim dhe përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shrytëzimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Vlerësimi cilësor i ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Materiali i mëposhtëm, autori i të cilit është ekspert mjedisi, është sipas Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të objektit: “Rikualifikimi i bllokut të Tregu Çam”. Për hartimin e këtij raporti janë bërë grumbullime materiale dhe të dhënash të cilat konsistojnë në:

- a) gjendjen aktuale të mjedisit ku do të ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshirë këtu edhe statusin ligjor të zonës;
- b) gjendja e infrastrukturës, elektrike, kanalizimet e ujërave para ndërtimit të objektit;
- c) projektin e ndërtimit;
- d) teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- e) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- f) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre.

1.1 PARIMET E HARTIMIT TË VNM-SË

Parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit, ku mbështetet edhe ky Raport VNM-je për objektin "Rikualifikimi i bllokut te Tregu Çam" janë:

- a) parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
 - b) parimi i kujdesit;
 - c) parimi i parandalimit;
 - d) parimi "ndotësi paguan";
 - e) i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar;
 - f) parimi i përgjegjësisë ligjore;
 - g) parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë;
 - h) parimi i integritit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale;
 - i) parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore;
 - j) parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.
- "*Zhvillimi i qëndrueshëm*" i cili është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes, pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.
 - "*Përdorimi i qëndrueshëm*" i burimeve natyrore i cili siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa cënuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.
 - "*Teknikat më të mira të mundshme*" përfaqësojnë fazën më të përparuar dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, të zhvillimit të një veprimtarie dhe që janë plotësisht të zbatueshme ngapakëpamja praktike dhe ekonomike.
 - "*Parimi i parandalimit*" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit me të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis.
 - "*Parimi i riaftësimit*" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetëpersonat fizikë e juridikë dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar.
 - "*Parimi "Ndotësi paguan"* nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.

1.2 QËLLIMI I KRYERJES SË RAPORTIT TË VNM-SË

Raporti i VNM-së për objektin: "RIKUALIFIKIMI I BLOKUT TE TREGU ÇAM", i cili do të përgatitet nga Eksperti i Mjedisit është një dokument bazë dhe i qëndrueshëm duke u bazuar në qëllimet kryesore dhe ato dytësore. Ky studim ka për qëllim:

- Të përshkruajë hollësisht në kohë dhe hapësirë projektin, aktivitetet kryesore të cilat kryhen.

- Të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e pritshme nga veprimtaritë që do të kryhen të cilat mund të jenë ndikime pozitive apo negative ndaj mjedisit ekzistues dhe përreth tij duke përfshirë banorët e qytetit që jetojnë përreth kësaj zone.
- Të identifikojë e të përcaktojë masat e mundshme e të domosdoshme që duhen marrë për eliminimin apo zbutjen e ndikimeve të pritshme negative gjatë aktiviteteve si dhe për të marrë masa për mbrojtjen, menaxhimin e zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit.
- Të identifikojë e të përcaktojë masat e mundshme e të domosdoshme që duhen marrë gjatë kryerjes së aktiviteteve të lartpërmendura.
- Të japë përfundimet dhe rekomandimet përkatëse për aktivitetet që do të kryhen.
- Të marrë në konsideratë të gjitha kriteret për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm e prespektiv të mjedisit gjatë kryerjes së aktiviteteve të lartpërmendura.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis merr në konsideratë, ndikimet jo vetëm gjatë zbatimit të projektit, por në mënyrë afatgjatë edhe pas përfundimit të tij. Ndikimet që mund të ndodhin mund të shfaqen menjëherë kur ndodh një ndërhyrje në mjedis apo shfaqen në mënyrë indirekte dhe ato mund të shfaqin shkallë të ndryshme rëndësie. Këto ndikime mund të jenë të ndryshme në kohëzgjatjen e ndikimit (Afatshkurtër, Afatmesme dhe Afatgjatë në kohë) dhe të ndryshme në karakterin e tyre (ndikim i përkohshëm dhe i përhershëm).

Ndikimet më të mundshme të cilat do të vlerësohen në vazhdimësi të këtij raporti përfshijnë disa aspekte si:

- Ekosistemet natyrore, fauna dhe flora.
- Toka dhe nëntoka.
- Cilësia e ajrit.
- Klima.
- Peisazhi.
- Shëndeti publik dhe cilësia e jetës.

Hartimi i këtij Raporti të VNM-se për projektin "RIKUALIFIKIMI I BLOKUT TE TREGU ÇAM" nga Eksperti i Mjedisit synon:

- Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohe të ndikimeve mjedisore, të projektit që do të zbatohet, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;
- Nje proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmeri
- Hartimi i ketij raporti VNM-je për objektin "RIKUALIFIKIMI I BLOKUT TE TREGU ÇAM" është bazuar gjithashtu në ligjin "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i cili në vetvete synon:
të rregullohet marrredhenia ndërmjet njeriut dhe mjedisit,
- të mbrojë përberesit e mjedisit dhe proceset mjedisore,
- të siguroje kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër,
- përdorim racional të mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e të ndotjeve në të, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit të dëmtuar,
- përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilesinë e jetës dhe mbrojtjen e shendetit tënjeriut,
- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore të përsëritshme dhe të papërsëritshme, administrimin racional dhe të frytshem të tyre,

- bashkerendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit,
- bashkëveprimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit,
- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtarinë për mbrojtjen e mjedisit,
- bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm,
- ngritjen dhe forcimin e rrjetit institucional mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe vendor.

Gjatë venies në punë të veprimtarive dhe instalimeve, personat fizike e juridike sigurojnë:

- i) zbatimin e të gjitha masave që parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit;
- ii) shmangien dhe pakesimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakesuar ndikimin në mjedis;
- iii) parandalimin e aksidenteve dhe kufizimin e pasojave të tyre;
- iv) kthimin e vendit në kushtë të kenaqshme mjedisore;
- v) njoftimin e agjencive rajonale të mjedisit, për rezultatet e vetëmonitorimit, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis;
- vi) plotësimin e kërkesave të Inspektoratit të Mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së tyre;
- vii) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor të veprimtarisë së tyre;
- viii) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet në mjedis, për përdorimin e ujit dhe të enërgjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

1.3 KUADRI LIGJOR VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR, POLITIKAT KOMBËTARE

Ligji për mbrojtjen e mjedisit përcakton dhe politikat shtetërore për mjedisin. Ky Raport VNM-je përmbush dhe është në përputhje me këtë ligj mbi politikat shtetërore për mjedisin si më poshtë:

1. Politika shtetërore për mbrojtjen e mjedisit synon zbatimin e kërkesave të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë për mjedisin. Në hartimin dhe zbatimin e saj angazhohen të gjitha organet shtetërore, secili në linjën e vet.
2. Organet shtetërore të ngarkuara me ligj për administrimin e përbërësve të mjedisit në politikat sektoriale, kombëtare e vendore, si transport, energji, bujqësi, turizëm, industri, shërbime, rregullim territori e zhvillim ekonomik e shoqëror, në tërësi, sigurojnë harmonizimin e zhvillimit ekonomik eshoqëror me mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

1.3.1 Kuadri ligjor kombëtar

Hartimi i kësaj VNM -je për zhvillimin e zonës së projektit të përshkruar në kapitujt në vijim, është i mbikqyrur nga disa institucione qendrore dhe ato lokale për zbatimin me rigorozitet të të gjitha ligjevedhe normave të parashtruara në ligjet përkatëse sipas institucioneve dhe kopentencave të tyre. Hartimi i këtij Raporti VNM është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 07.07. 2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ku sipas Shtojcave të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe projekti në fjalë i nënshtrohen Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Gjithashtu hartimi i këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i cili është përafuar plotësisht me Direktiven 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Keshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin".

Kuadri ligjor vendor, legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket mund të përmendim:

- Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis",
- Ligjin Nr .10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit ",
- Nr. 10448 datë 14/07/2011 "Për lejet e Mjedisit ",
- Ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa" në ligjin Nr. 8897 datë 16/5/2002 "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja "
- Nr.9115 datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura",
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja",
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit",
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008,
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.6/2015, datë 12.2.2015, botuar në Faqen Zyrtare nr.31.
- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996: "Për largimin publik të mbeturinave",
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009,
- Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me uje dhe të largimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura", i ndryshuar me Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005, Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008,
- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme", i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009,
- VKM. Nr. 835, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listës se mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhembeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi",
- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit",
- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006, "Për miratimin e strategjise dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor,

- V.K.M Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajer në Republikën e Shqipërisë",
- V.K.M Nr.267, datë 24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike",
- V.K.M Nr.994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin",
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve",
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengeta dhe kritëret e zonimit të mjediseve ujore pritëse",
- Nr.3, datë 119.11.2009, "Për miratimin e metodologjise se vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të nje veprimtarie",
- Udhezim Nr.6527, datë 24.12.2004, "Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe menytrat e kontrollit të tyre",
- Udhezim, Nr.5, datë 28.12.2007, "Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore",
- Udhezim, Nr.6, datë 27.11.2007, "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afatëve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta",
- Udhezim, Nr.1, datë 07.01.2008, "Për dokumentacionin e domosdoshem për të kërkuar leje mjedisore",
- Rregullorja Higjieno-Sanitare datë.17.11.1997 "Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave",
- Rregullore, Nr.1, datë 30.03.2007, "Për trajtimin e mbetjeve të ndertimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre".

1.3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Shqipëria është një vend i cili është tashmë nënshkruar i shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Ky raport duhet të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal, kombëtar dhe me poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapën kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit:

- Protokollin e Kievit "Për vlerësimin strategjik mjedisor". Ratifikuar në vitin 2005.
- Protokollin e Kartagjenës "Për biosigurinë". Bere pale në vitin 2005.
- Konventa e Stokholmit "Mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm", Ligji nr. 9263. Datë 29.07.2004.
- Protokollin e Kartagjenës "Për sigurinë biologjike", Ratifikuar në vitin 2004, Ligji nr.9279, datë 23.09.2004.
- Konventa e Washingtonit "Për tregëtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të flores dhe faunës së eger", Ligji nr. 9021, datë 06.03.2003.

1.3.3 Kuadri ligjor Europian

Raporti i VNM-së për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqësojë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Keshillit të Europes, kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushen e politikës së ujërave.

- Direktives KE 42/2001 (të Keshillit të Evropes), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Keshillit të Evropes (21 Maj 2008) "Mbi cilesinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Keshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 2001/42/CE e Keshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planëve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Keshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të DisaProjektëve Publike dhe Privatë mbi Mjedisin.
- Direktiva e Keshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilesise se ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lendet grimcore dhe Pb në ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilesinë e ujrave të embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme. Referimet në nivel komunitar në fushen e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të përzgjidhen ato me kryesoret. Shqipëria ka firmosur shume konventa dhe protokolle ku mund të përmendim disa prej tyre:
 - Konventën e Aarhus për akses në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje ambjentaliste dhe akses të drejtësise në ceshtjet ambjentaliste, të ratifikuar me Ligjin Nr.8672, date 26 tetor 2000.
 - Konventa Nderkombetare Detare "Për Përgatitjen Ndaj Ndotjes Nga Nafta, Reagimi dhe Bashkeveprimi (Oprc), 1990" Ratifikuar Nga Rsh Me Ligjin Nr.9692, Datë 8.3.2007.
 - Konventën Nderkombetare "Për Përgjegjesinë Civile Për Demet Nga Ndotjet Me Karburant", 1992, Ratifikuar nga RSH me Ligj Nr.9293, datë 21.10.2004.
 - Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të medha, Gjeneve, Zvicer, me 13 nëntor 1979.
 - Konventa për Ruajtjen e Flores dhe Faunës së eger dhe mjedisit natyror të Europes në Bernë, 19shtator 1979
 - Konventën e Rio De Janeiro-s për Biodiversitetin, të ratifikuar me 10 Nëntor 1996,
 - Konventa Ndërkombetare Detare "Për Parandalimin e Ndotjeve Nga Anijet, 1973".

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE

2.1 MBULESA BIMORE E ZONËS

Nga sipërfaqia totale prej 165,200 ha në qarkun e Tiranës, pyjet mbulojnë 32% të kësaj sipërfaqe. Gjendja e këtyr pyjeve në përgjithësi është e mirë. Një pjesë e rëndësishme e fondit pyjor në qarkun e Tiranës përbëhet nga zonat që kanë statusin e zonave të mbrojtura. këto zona të mbrojtura përbëhen nga pyjet e Parkut të Dajtit, Farkë, Bërzhit dhe të bërddhetit që zënë një sipërfaqe prej 27,820ha.

Në territorin e Tiranës gjendet një shumëllojshmëri e bimëve dhe e kafshëve të egra që formojnë habitatet e tyre natyrore. Vegjetacioni është i larmishëm dhe fillon që nga zonat bregdetare dhe deri në majat më të larta të maleve të këtij qarku. Shumëllojshmëria në florë dhe në faunë në këtë Bashki është e përqëndruar më tepër rreth zonave pyjore të NjA-së Lumas, Kozarë dhe Perondi. Fatmirësisht, NjA-të Lumas dhe Kozarë kanë plane manaxhimi për fondin pyjor ndërsa NjA-ja Perondi nuk e ka një plan të tillë.

Struktura pyjore përbëhet nga Pisha e egër, Pisha e butë, Plepi, Selvia, Akacia dhe shkurret e Makias. Mbi lartësinë 1,000 m mbi nivelin e detit mbizotëron zona e lisit. Me ngjitjen më lartë se zona e lisit fillon zona e ahut dhe më tej ndodhet zona e haloreve. Në majën e maleve të qarkut të Tiranës shtrihen livadhet alpine ose nuk ka fare bimësi.

2.1.1 Zonat e mbojtura

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore. Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj dhe zënë rreth 16% të territorit të vendit. Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kriteret: i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore, vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

2.1.2 Flora

Tirana bënë pjesë në brezin e shkurreve dhe drurë mesdhetarë ku përmendim pyjet halore, gjethegjerë. Në zonat përreth Tiranës vazhdojnë të mbijetojnë në pakicë si: makiet, shiblaku, driza (paliurus spina-christi), cermedelli (cotunus coggyria), shqemia (rhus coriaria), shegë (punica granatun), gorrice (pyrus amygdaliformis), murrizët, thana, etj. Në këtë zonë janë mbjellë bimë zbukuruese (Pinus nigra, picea conica, talus baccata, juniperus virginiana, etj).

Ne vende të patrajuara me infrastrukture urbane të zonave që parashikon projekti, buze rrugëve të pashtruara, gjenden e Mellaga e eger (Malva sylvestris L.), trasta e bariut (Capsella bursa-pastoris), nejca piper uji (Polygonium hydropiper L.), çikorja ose radhiqja, (Cichorium intybus L.), laboti heshtak (Atriplex hastatum L.), nejca me gjethe pjeshke

(*Polygonum persicaria* L.), lepjeta e kopshtit (*Rumex patientia* L.), zhabina e arave (*Ranunculus arvensis* L.), fomi mjeksor (*Fumaria officinalis* L.), agrimonia (*Agrimonia eupatoria* L.), zorreca (*Potentilla reptans* L.), terfili i verdhe (*Trifolium campestre*), grami zvaranik (*Agropyrum repens* L.) akilega (*Aquilegia vulgaris* L.) etj.

Ne hapësira buze banesave, familjaret kanë mbjelle shkurre dekorative, drure dekorativ si rrapë (*Platanus orientalis*), selvi (*Cumpressus sempervirens*) lajfata (*Cercis siliquastrum*), drure frutor të kultivuar si pjeshka (*Prunus armeniaca*), lajthia (*Corylus avelana* L.), kumbulla (*Prunus domestica*), hardhia (*Vitis vinifera*), ulliri (*Olea europea* L.).

2.1.3 Fauna

Në zonat pyjore të qarkut të Tiranës jetojnë kafshë të ndryshme si ujku, dhelpra, derri i egër, arriu i murrëm, lepuri i egër, macja e egër dhe një numër i shumtë shpendësh. Habitatet natyrore janë një pasuri e paçmuar që ndikon në cilësinë e mjedisit të këtij qarku. Prandaj mbrojtja e biodiversitetit të zonës përbën një prioritet dhe është e kushtëzuar drejtpërdrejt nga ruajtja e habitateve natyrore të kësaj zone.

Zona e projektit ka një larmishmeri të habitatit shtazor, ku me poshte jete një liste të plote të specieve të kafsheve të vërejtura në terren. Disa specie të vezhguara të gjarperinjve, zogjve, gjitareve të vegjël dhe amfibeve përcaktohen në Direktivat e BE për Habitatet e Flores dhe Faunes, Shtojca II dhe IV dhe në Direktivat e BE për Zogjte.

- **GJITARET:**

- *Lutra lutra* (vidra e zakonshme)
- *Plecotus auritus* (lakuriqi veshgjate)
- *Nyctalus noctula* (lakuriqi i nates)

- **ZOGJTE:**

- *Hippolais olivetorum* (çafka e ullirit)
- *Sylvia nisoria* (çafke)

- **ZVARRANIKET:**

- *Emys orbicularis* (breshke e moçalit)
- *Mauremys caspica* (breshke e moçalit)
- *Testudo hermanni* (breshke mesdhetare e tokës)
- *Natrix tessellata* (gjarper)
- *Lacerta trilineata* (hardhucë e gjelber me tre vijë)
- *Lacerta viridis* (hardhucë e gjelber)
- *Podarcis taurica* (hardhucë)

- **AMFIBET:**


- *Rana lessonae* (bretkose e vogël uji)
- *Hyla arborea* (zhabe pemë)
- *Triturus cristatus* (salamander)
- *Bufo viridis* (zhabe e gjelber).

2.2 MJEDISI FIZIK

Objekti “Rikualifikimi i bllokut te Tregu Çam” për të cilin do të hartohet Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis eshte e vendosur ne territorin e Bashkise Tirane, Qarku i Tiranës, ne nje largesi prej 300 m nga Sheshi Skenderbej.

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) ka identifikuar dhe vlerësuar rëndësinë e ndikimit të fuqishëm ambientalist në Projektin: “Rikualifikimi i bllokut te Tregu Çam” të jenë të pranueshme dhe brenda standarteve të aplikuara, të përshkruara nga Ministra Shqiptare e Mjedisit.

Rikualifikimi i zones se Tregut Çam duke e kthyer ne nje pike kyçe te kryeqytetit dhe rikonstruksioni i rrugeve te kesaj zone per rritjen e cilesise se jeteses se banoreve dhe vizitoreve te kesaj zone.




2.2.1 Gjeologjia

Jane rishikuar te gjitha punimet e meparshme gjeologjike te kryera nga autore te tjere vendas te cilat jane kryer per qellime te tjera por kane vlera njohese. Jane shikuar te gjitha studimet e botuara dhe te pa botuara per zonen ne fjale.

Ne ndertimin gjeologjik te zones se studimit tone takohen depozitimet me moshe relativisht te re, te cilat duke filluar nga ato me moshe me te vjeter tek ato me te reja, jane:

1. Depozitimet e Tortonianit N(121)
2. Depozitimet proluviale te Kuaternarit (Q4pl)
3. Depozitimet deluviale te Kuaternarit (Q4dl)
4. Depozitimet aluviale te Kuaternarit (Q4al)
5. Shkembinjte Neogjenike



*Figura 2 Struktura Gjeologjike e Qarkut te Tiranës
Zona kryesore strukturale të Tiranës janë paraqitur në Figurën 2*

Depozitimet e Tortonianit N₁²¹

Ndertojnë pothuajse te gjithë rrethin e Tiranës. Ne pjeset kodrinore ato i takojme nen mbulesen e tokes vegjetale apo kane dalje direkte ne siperfaqe.

Ne pjesen qendrore ku ndodhet edhe qyteti i Tiranës ato ndodhen ne depozitimet me te reja te Kuaternarit (deluviale dhe aluviale) duke mbushur keshtu te ashtuquajturen gropa e Tiranës.

Depozitimet e Tortonianit perfaqesohen nga nderthurje pakove te ranoreve me pako argjilitesh e alevrolitesh. Ne mes te pakove te ranoreve takojme nderfutje te pakove te holla konglomeratike.

Pjesa e sipërme e ketyre shkembinjëve është e perajruar, perajrim qe ne pjeset kodrinoro-shpatore arrin deri 6-8m e vende vende me teper,ndersa ne pjesen qendrore fushore ky perajrim është 2-3m e vende vende me pak.

Kryesisht keto depozitime paraqiten me ngjyre grit te kalter (te fresket) dhe kafe te verdhe me njolla ndryshku (te perajruar).

Gjendja e lageshtise varion ne kufij te gjere, ne argjila e alevrolite kemi pak lageshti ndersa ne kontaktin argjilito-ranor kjo sasi shtohet shume,e shpesh kthehet ne burim furnizimi me uje (ne sasi te pakten deri 0.1 l/s).

Shkalla e ngjeshjes e ketyre depozitimeve është e larte ndersa shkalla e çarshmerise luhatet, ne pjeset shpatore është e larte ndersa ne ato qendrore është e ulet.

Trashesia e depozitimeve te Tortonianit per depozitimet e fresketa është 50-200m ndersa per depozitimet e perajruara 6-8m.

Depozitimet proluviale te Kuaternarit (Q4 pl)

- *Depozitimet proluviale* perfaqesohen nga suargjila, surera ,suargjila zhavorore, zhavore dhe rera.

Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara, takohen ne nje pjese te sheshit te studjuar. Keto depozitime nderthuren me tipet e tjera te depozitimeve sidomos me depozitimet aluvialo liqenore.

Depozitimet deluviale te Kuaternarit (Q4^{dl})

Perfaqesojne mbushjet e tarracave te lumenjeve te Lanes ashtu dhe te lumit te Tiranës.

Ato perfaqesohen nga suargjila te mesme me ngjyre kafe te kuqerremte, te verdhe si kafe te erret.

Depozitimet deluviale kane nje trashesi e cila luhatet ne kufij te gjere nga 2-3m deri ne 8-10m.

Kjo trashesi varet nga pozicioni i studimit si dhe nga kushtet e depozimitit te materialit te ngurte qe kane sjelle keto lumenj si dhe nga largesia me ta. Kryesisht depozitimet deluviale vendosen mbi depozitimet aluviale dhe luajne rolin e tapes per ujerat qe kane depozitimet aluviale.

Materiali i tyre mbushes është ne sasi qe luhatet nga 50% deri ne 30-40% e vende vende me shume dhe perfaqesohet nga zhavorre me madhesi 3-4 cm rralle me te medhenj si dhe nga çakull ne masen qe vende vende shkon 40-50%.

Perberja litologjike e tyre është kryesisht karbonatike e ranorike.

Gjate studimeve fushore si dhe studimeve te kryera me pare ne rrethin e Tiranës depozitimet deluviale paraqiten ne gjendje plastike dhe me nje lageshti qe luhatet ne kufij te gjere. Ndersa persa i perket ngjeshmerise shkalla e tyre luhatet nga me ngjeshmeri

mesatare deri te ngjeshura.

Depozitimet deluviale nga pikpamja litologjike perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te renda e me pak, ne forme linzash, surerash e akoma me pak rera.

Depozitimet e Kuaternarit (Q₄^{al})

Depozitimet aluviale vendosen direkt mbi tavanin e derthurjeve te pakove ranoro-argjilore. Keto depozitime perfaqesojne materialin aluvial te tarracave te lumenjeve te Tiranes.

Nga punimet fushore te kryera ne kete shesh ndertimi si dhe studimet e kryera ne kete zone, trashesia e ketyre depozitimeve luhetet nga 7.0 deri 10-40m.

Nga perberja litologjike depozitimet aluviale jane depozitime te ndryshme dhe perfaqesohen nga zhavore e zhure (poplat jane ne % te paket), kryesisht gelqerore e me pak ranore e akoma me pak bazike e ultrabazike.

Depozitimet aluviale jane te perpunuara deri ne gjysem te perpunuara.

Shkalla e ngjeshmerise e tyre eshte e larte, ndersa gjendja e lageshtise e tyre eshte e ngopur me uje.

Materiali mbushes perfaqesohet nga rere e surera ne masen 10-30%.

Shkembinjte Neogjenike

Keto shkembinj jane me origjine sedimentare perbehen nga argjilite alevrolite dhe ranore jane me ngjyre bezhe ne gri jane me carje dhe shume te perajruara. Shkalla e perajrimit zvogelohet me rritjen e thellesise. Keto depozitime dalin ne siparfaqe ne kodrat per rreth qytetit te Tiranes.

2.2.2 Klima

Faktoret klimatike te nje rendesie paresore jane rreshjet dhe menyra e perhapjes se tyre, lageshtia, temperatura dhe era, te cilat ndikojne ne avullimin dhe transpirimin.

Faktoret klimatike te cilet jane mare ne konsiderate ne analize perfshijne:

Temperatura e ajrit, rreshjet dhe analiza e tyre, bora dhe era, stuhite.

Te dhenat qe mbeshtesin kete analize jane mare nga vendmatjet te zgjedhura.

2.2.3 Temperatura e ajrit

Ndonese territori qe perfshin Bashkia e re Tiranë perfshihet ne 3 zona klimatike: mesdhetare fushore, mesdhetare kodrinore dhe mesdhetare paramalore, ne pjesen me te madhe te tij mbizoteron klima mesdhetare fushore me dimër te butë dhe verë te nxehtë.

Nje nga elementet bazë qe karakterizon klimen e nje zone eshte regjimi i diellzimit, i shprehur me ane te numrit te diteve te kthjellëta e te vranëta. Per zonën ne studim, numri i diteve te kthjellëta luhetet nga 6-7 dite ne muajt e dimrit deri ne 16-19 dite ne muajt e verës. Mesatarisht gjate vitit vrojtohen rreth 1-2 dite te vranëta ne periudhen e verës dhe 10-12 dite te tilla gjate e dimrit.

Ne tabelen e meposhtme tregohet kohëzgjatja mesatare e dites sipas muajve si dhe mesatarja e diteve me temperature mbi 32°C dhe nen 0°C.

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Kohëzgjatja mesatare e ditës (orë)	12.7	10.1	11.1	12.4	13.8	15.1	15.7	15.3	14.3	12.9	11.5	10.4	9.8	3
Nr. i ditëve me temp. > 32°C	31	-	-	-	-	-	3	11	15	1	-	-	-	3
Nr. i ditëve me temp. < 0°C	34	10	6	7	-	-	-	-	-	-	-	-	10	3

Për rajonin e Tiranës rezulton se vlerat mujore të rrezatimit të përgjithshëm luhaten nga 135,6kal/cm² në muajin dhjetor deri në 570 kal/cm² në muajin korrik. Shifrat tregojnë një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore për zonën në studim, element ky shumë i favorshëm për zhvillimin ekonomik të zonës.

Temperatura mesatare vjetore është 15°C dhe kemi të bëjmë me një regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vërohet në muajin Janar me 6°C, ndërsa temperatura maksimale vërohet në muajt Korrik dhe Gusht, 24°C.

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Temp. mesatare (°C)	15	6	7	8	12	17	21	24	24	20	16	11	8	3
Temp. max. mesatare (°C)	21	11	12	13	18	22	27	31	32	27	22	16	13	3
Temp. min. mesatare (°C)	9	2	2	3	7	12	15	17	17	13	10	7	3	3

Rajoni merr sasi të mëdha oresh me diell. Vlera e zgjatjes vjetore të diellit leviz në kufinjte 2600-2700 ore. Numri i ditëve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat më të larta janë vërtuar në Korrik, 373 ore me diell, dhe më të ultat në dhjetor 118 ore.

2.2.4 Reshjet atmosferike


Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishme klimatike që përcaktojnë veçoritë klimatike të një zone.

Në rastin e projektimit të një rrugë, veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhet direkt me mirëmbajtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet edhe me kushtet e transportit të mjeteve levizëse. Faktoret që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve atmosferike janë në pozicionin gjeografik, afërsia me detin dhe horografia.

Për shkak të veprimtarisë ciklonare sasia e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën më të ftohtë të vitit, dhe ajo më e ulët në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh të uleta vjetore mesatarisht 931 mm në vit të cilat bëjnë forme shiu.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirane	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	1353

Reshje mujore dhe vjetore



Shperndarja e reshjeve gjate vitit ka nje forme "U" qe eshte tipike e nje regjimi Mesdhetar te reshjeve. Sasia me e madhe e reshjeve pritet gjate periudhes se ftohte te vitit dhe muajt me te laget jane Nentor-Dhjetor (211 dhe 173 mm perkatesisht). Muaji me i thate eshte Korriku-Gushti (32 mm).

Pervec reshjeve mujore e vjetore, rendesi paraqesin edhe shpeshtesia e shfaqjes se reshjeve te vogla si: 0.1 mm, 1.0 mm, 5 mm dhe 10 mm. Per kete qellim jane llogaritur per gjithe periudhen me te dhena per vendmatjen meteorologjike Tirane numri i diteve me reshje > 0.1 mm, >1.0 mm, >5 mm dhe >10 mm.

Vendmatja	Numri i diteve			
	Reshje >0.1mm	Reshje >1mm	Reshje >5mm	Reshje >10mm
Tirane	129	100	64	45

Karakteristikat kryesore te reshjeve

Reshjet intensive ne sasi te medha per intervale te ndryshme kohezgjatje dhe sidomos per kohezgjatjet e medha, vrojtohen situata te caktuara sinoptike dhe sidomos ku ciklonet dhe frontet atmosferike jane stacionar. Ato gjithashtu jane te lidhura me llojin e reve dhe te ndikimeve lokale.

Duke pasur parasysh sasine maksimale per 24 ore te reshjeve dhe intensitetin per intervale te ndryshme kohe ne periudha te ndryshme kthimi (return periods) zona ne studim karakterizohet per intensitete te larte te reshjeve. Ne vendmatjen meteorologjike Tirane brenda 24 oreve kane rene 237.4 mm.

Si ndryshim i ndryshueshmerise se madhe ne kohe dhe hapesire te reshjeve maksimale 24 oreshe, e domosdoshme eshte edhe se cfare sasi reshjesh jane te mundshme gjate 24 oreve ne zonen ne studim dhe sa shpesh perseriten ato.

Per kete qellim u llogariten reshjet maksimale per periudha perseritje te ndryshme.

Ne tabelle jepen reshjet maksimale mujore dhe vjetore:

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Me e larta
Tirane	85	89	65	77	123	103	59	79	98	237	194	130	237

Maksimumi 24 oresh i reshjeve

Si ne rastin e reshjeve 24 oresh per qellime praktike ne tabelle jepen reshjet 24 oresh me siguri te ndryshme; gjithashtu ne tabelen me poshte jepen lartesisite maksimale te reshjeve per kohezgjatje 10', 20', 30', 1h, 2h, 6h dhe 12h me periudhe perseritje nje here ne 100 vjet, 50 vjet, 10 vjet dhe 2 vjet.

Nr	Vendmatja	Siguri te ndryshme					
		1	2	5	10	20	50
1	Tirane	180	162	141	124	106	78

Reshjet me te medha me siguri te ndryshme

Vendmatja	100%							20%							5%						
	10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h
Tirane	32	38	46	66	92	128	167	29	35	40	53	80	114	144	25	30	35	47	69	97	123

Lartesisite maksimale te reshjeve per kohezgjatje 10', 20', 30', 1h, 2 h, 6 h,dhe 12 h dhe periudhe perseritje 100 vjet, 50 vjet, 10 vjet dhe 2 vjet

10%							20%							50%						
10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h	10"	20"	30"	1 ^h	2 ^h	6 ^h	12 ^h
22	27	32	42	60	84	106	19	24	28	35	51	71	88	14	19	22	28	38	51	62

Deborra

Ne vendin tone, ne periudhen e ftohte te vitit, nje sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej bores. Kjo vecori eshte me e theksuar ne zonen malore ku bora eshte nje dukuri e zakonshme.

Ne zonen ne studim bora vrojtohet rralle dhe mund te konsiderohet si dukuri e jashtezakonshme. Numri me i madh i diteve me bore ne zonen ne studim eshte rreth 3 dite ne vit.Nga te dhenat e tabelës rezulton se muaji Janar ka numrin me te madh te diteve me bore, duke u ndjekur nga Shkurti dhe Dhjetori.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma vjet.
Tirane	1.3	0.9	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.3	1.3

Numri mesatar i diteve me bore

Ne zonen ne studim, per shkak te ndikimit zbutes te detit nuk ka kushte te pershtatshme per krijimin e shtreses se bores. Ajo krijohet rralle, por edhe kur krijohet, nuk mund te qendron gjate. Bora krijon shtrese dhe mund te qendroje gjate vetem ne dimra te jashtezakonshem te shoqeruar me temperatura negative te uleta te vazhdueshme sic kane qene rastet e vitit 1949 ku bora arriti lartesine 40cm dhe qendroi disa dite, Dhjetori i 1957 dhe Janari 1985. Mund te permendim edhe vitet 1954-1955, 1960 dhe 1965. Lartesia mesatare maksimale e shtrese se bores ne Tirane arrin 8cm.


2.2.5 Clesia e ajrit

Cilësia e ajrit është një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë shëndetin dhe cilësinë e jetës së popullatës së çdo vendi. Në Shqipëri të dhënat mbi cilësinë e ajrit janë të pakta sepse monitorimi në shkallë vendi nuk është as gjithpërfshirës, as i përhershëm, dhe ka nevojë për shumë përmirësime. Rrjeti ekzistues i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri është i kufizuar në aspektin e numrit të stacioneve monitoruese po ashtu edhe në tipin e stacioneve. Duke qenë kryeqyteti i vendit dhe qendra më e madhe urbane në vend, Tirana është e përfshirë në rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit i cili zhvillohet bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit.

Bazuar edhe në direktivën CAFE të BE për ajrin janë kryer matje për 6 ndotës kryesorë ku përfshihen: PM10, NO_x, SO₂, O₃, CO dhe BTEX. Për Tiranën, monitorimi kryhet me dy stacione të vendosur përkatësisht pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, por për shkaqet e sipërcituara monitorimi në to nuk është i vazhdueshëm. Rezultatet e monitorimit, publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në Raportin e Gjendjes në Mjedis, shprehur në formën e një trendi krahasues me vitin 2014, tregojnë përkeqësim të gjendjes së cilësisë së ajrit për disa nga ndotësit. Është rritur përqëndrimi në ajër i lëndës së grimtuar PM10, gazit ozon O₃ dhe dioksidit të azotit NO₂. Vlerat e regjistruara evidentojnë faktin që çështja më kritike në lidhje me cilësinë e ajrit në Tiranë është përqëndrimi i lartë në të i lëndës së grimtuar PM10, ndryshe pluhurit.


PM10 i referohet grimcave me diametër 10 micrometër ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO₂, NO_x, NH₃ dhe NMVOC. Ekspozimet, si afatshkurtëra edhe afatgjata, kanë treguar se shkaktojnë sëmundje të frymëmarrjes dhe të zemrës, efekte të tjera të dëmshme shëndetsore dhe vdekje (OBSH, 2007). Ekspozimet afatgjata kontribuojnë në rrezikun e kancerit të mushkërive (OBSH, 2008).

Në grafikun e mëposhtëm shihet që vlera mesatare vjetore e përqëndrimit të lëndës së grimtuar, e cila përfaqëson një nga ndotësit kryesorë të ajrit për qytetin e Tiranës, për të dy stacionet e kalon vlerën limit të BE që është vetëm 40 µg/m³. Vlera më e lartë prej 64.95 µg/m³ është regjistruar në stacionin AKM dhe e kapërcen 76% normën.



Burimi: Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2015, AKM

Në zbatim të direktivës së mësipërme matjet për përqëndrimin e PM10 janë kryer me bazë ditore. Për të dy stacionet e Tiranës mbetet problem kryesor pikërisht numri i ditëve që tejkalojnë standartin ditor sipas BE. Numri i ditëve që e tejkalojnë vlerën prej 50 µg/m³ që është standarti ditor i BE në stacionin AKM është 67 ditë/6 muaj kundrejt 35 ditëve në vit që është limiti i lejuar.




Burimi: Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2015, AKM

Gjithashtu matjet e kryera kanë treguar kapërcim të vlerave të lejuara për NO₂.

Dioksidi i azotit NO₂ në nivele të larta shkakton inflamacion të rrugëve të frymëmarrjes. Te njerëzit me shenja azmatike ekspozimi ndaj tij sjell efekte reversibël në funksionin e mushkërive, dhe mendohet se shkakton reagim të ekzagjeruar ndaj alergjentëve, ajrit të ftohtë dhe aktivitetit fizik. Ekspozimi ndaj tij i vendos femijët nën rrezik të rritur për semundje të frymëmarrjes (OBSh, 2000).

Vlera më e lartë është regjistruar në stacionin MM dhe është 42.38 µg/m³ përkundrejt standartit vjetor të BE-së i cili është 40 µg/m³, ndryshe 6% më e lartë.



Burimi: Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2015, AKM

Gjithashtu është monitoruar përqëndrimi në atmosfere i SO₂ dhe benzenit, të cilët për qytetin e Tiranës kanë rezultuar brenda normave të lejuara.

Dioksidi i sqfurit SO₂ prodhohet prej djegies së lëndëve djegëse industriale e shtëpiake. Ekspozimi afatshkurtër ndaj përqëndrimeve të larta të tij rezulton në reduktim të funksionit të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë mendohet se çon në sëmundje respiratore të fëmijëve dhe vdekshmëri të rritur të të gjitha moshave (OBSH, 2005). Fëmijët e vegjël dhe njerëzit që vuajnë prej azmës dhe sëmundjeve kronike të frymëmarrjes janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj SO₂.

Hidrokarburet aromatike BTX të cilat janë kancerogjenë të njohur dhe kanë një numër burimesh. Benzeni është ai që ka më shumë rëndësi e që monitorohet dy vitet e fundit në qytetin e Tiranës. Hidrokarburet aromatike digjen lehtë duke prodhuar monoksid karboni dhe dioksid karboni. Frymëmarrja e hidrokarbureve aromatike në përqëndrime të lartë për periudha të gjata kohe shkakton lodhje, dhembje koke, marrje mendsh dhe të vjella.

2.2.6 Biodiversiteti

- Biodiversiteti në Shqipëri

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike, duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km. Zona veriore e vendit ka një relief malor, ku karakterizohet nga diveritet i formacioneve shkëmborë që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.


Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në teritorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth 7,233 taksonë bimore (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe 5,438 lloje kafshësh (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit, etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa kullotat zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore. Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. Liqenet e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratorë. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit. Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratorë dhe insektet.

- Speciet e rrezikuara në Shqipëri

Në territorin e vendit gjenden rreth 91 lloje të kërcënuara specimesh në nivel global. Në këtë listë përfshihen pelikani kaçurrel (*Crispus crispus*), breshka shqiptare e ujit (*Pelophylax shqipericus*) dhe blini (*Acipenser sturio*), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm. Sipas IUCN, 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuar.

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX - Të zhdukura	0	5
CR - Të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN -Të rrezikuara	123	56
VU - Të pambrojtura	120	154
LR - Rrezik i ulët	59	238
DD - Mungojnë të dhëna	30	72
NE - Të pavlerësuar	3	7



- Biodiversteti në Bashkinë Tirane

Kjo zone është e dominuar nga zhvillimi urban dhe nuk mbartë vlera të veçanta të

biodiversitetit që mund të merren në konsideratë gjatë rikualifikimit. Bimësinë natyrore në zonështë është kondicionuar nga niveli i ulet i terrenit, cilësitë edafike, si dhe potenciali i ulët i ujrave nëntoksore.

2.2.7 Zhurmat (Ndotja Akustike)

Në udhëzimin Nr. 8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” përcaktohen nivelet e lejuara të zhurmave në mjedise të caktuara.

Si mjedise të caktuara, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, janë identifikuar mjediset e zonave të banimit, (jashte banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike.

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha baze (ore)	LAmaz Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	-
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	-
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashte)	45	8	-
Institucione				
Klasa mesimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshitresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	
Dhomat e fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkolles, vendet e lojrave ne shkolle	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit naten	30	8	40
	Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim ne pushim, clodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social- ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Dentim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, te jashtme apo te brendshme	Dentim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argetime	Dentim degjimi (klientet < 5 here/ vit)	100	4	110
Muzike nepermjet kufjeve te degjimit	Dentim degjimi	85 # 4	1	110
Tinguj - zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armet e zjarrit	Dentim degjimi (te riturit)	-	-	140#2
	Dentim degjimit (femijet)	-	-	120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A

Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja

LAmaz Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)

1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (LAmaz, fast) matur 100 mm larg veshit.

3 = Zonat e jashteme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.

4= Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat fushes se lire

Përcaktimi i nivelit të zhurmave

Prodhimi i zhurmës dhe dridhjeve shkaktohet nga ana e funksionimi i pajisjeve të rënda dhe automjeteve të ndërtimit në/ nga vendi i ndërtimit. Kontraktuesi duhet të përgatisë një plan ndërtimi për uljen e zhurmës dhe të dridhjes duke marrë këto masa:

- ❖ Kontrolli inxhinierik, si:
 - 1) përdorimin e pajisjeve të tipit me zhurmë të ulët,
 - 2) përdorimi i zhurmëmbytëseve,
 - 3) mbyllja e shesheve të ndërtimit, dhe
 - 4) montimi i barrierave;

- ❖ Kontrolli administrativ, si:
 - 1) marrëveshja e rotacionit të punës dhe
 - 2) shmangia e punës gjatë natës, veçanërisht pranë zonave të ndjeshme ndaj zhurmës (Psh., spitalet dhe shkollat).Gjatë fazës së ndërtimit rekomandohet monitorim i rregullt.

- **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MË TË RËNDESISHME NË MJEDIS**

Në këtë kapitull do të identifikojmë ndikimet e mundshme që do të ketë në mjedis ndertimi i objektit “Rikualifikim i bllokut te tregu Çam”.

Me poshte paraqiten ndikimet që konsiderohen të rëndësishme gjatë fazave të ndryshme të projektit. Në raport me kohëzgjatjen e efektit të tyre, ato janë afatshkurtra dhe afatgjata.

Sipas natyrës së tyre, ndikimet mund të renditen:

- Ndikimet që janë të pamunduara të ndodhin, sepse natyra dhe fusha e projektit dhe modelet e tij mjedisore janë të tillë që faktorët përgjegjës për shkaktimin e ndikimit në mjedis mungojnë/kanë magnitudë të neglizhueshme, ose receptorët e ndjeshmërisë nuk ekzistojnë;
- Ndikimet përfituese ose keqësuese të nën-ndara brenda tyre, që kanë rëndësi të moderuar ose të lartë dhe kanë ndikim në performancën mjedisore të fazës para dhe post- operative të projektit;
- Përgjithësisht, ndikime relative keqësuese të vogla që duhet të zbuten, në interes të përmirësimit të performancës mjedisore.

3. INFORMACION PËR ORANINË E BURIMEVE UJORE

3.1 HIDROLOGJIA

Qarku i Tiranës ka burime të shumta ujore, jo vetëm burime karstike dhe lumenj, por edhe ujëmbledhës, liqene artificialë dhe ujëra nëntokësore. Lumenjtë kryesorë janë Erzeni, Ishmi, si dhe disa përrenj si Lana, përroi i Darçit dhe ai i Leshniqes (ose i Kavajës), që i përkasin rrethit Kavajë e derdhen të veçuar në Jug të gjirit të Durrësit. Burimet kryesore karstike janë ato të Selitës (215-1070 lit/ sek), Shënmërisë (270-380 lit/sek), Pëllumbasit (250-800 lit/ sek), Bovillës (110-850 lit/sek) etj. Duhet theksuar se fusha e Tiranës është shumë e pasur me ujëra nëntokësore, madje edhe në territorin e qarkut të Tiranës këto ujëra janë mjaft të cekët. Aktualisht ato konsiderohen si rezerva të rëndësishme për furnizimin e popullatës së kryeqytetit me ujë të freskët. Liqenet kryesore artificialë janë Bovilla, i cili është furnizuesi kryesor i kryeqytetit me ujë të pijshëm, liqeni i Tiranës dhe disa ujëmbledhës të cilët shfrytëzohen për ujitje, kryesisht për tokat bujqësore, siç është ai i Farkës.



Uji është një pasuri natyrore me vlera të mëdha kombëtare. Ai ka përdorim të madh në bujqësi, në industri dhe për furnizimin e qendrave të banuara. Pozita gjeografike në brigjet e detit Adriatik dhe të detit Jon, kushtet klimatike, relievi i thyer, kryesisht kodrinoro-malor, përhapja e madhe e shkembinjve të përshkueshëm nga uji dhe veprimtaria e njeriut kanë kushëtzuar pasuritë e mëdha ujore dheshumellojshmerine e tyre: dete, liqene, lumenj, perrenj dhe buriine ujore. Për shkak të veçorive morfologjike, Shqipëria është shumë e pasur në lumenj.

Diga e Liqenit Artificial të Tiranës është pjesë e Parkut të Tiranës, i cili është shpallur Park Kombëtar. Ndërtimi i kësaj dige është bërë për të krijuar një kompleks tërheqës për banorët e Tiranës. Diga e Liqenit Artificial të Tiranës është ndërtuar në vitet 1957-1958. Është digë homogjene (dheu), me vëllim të trupit të digës 110000 m³. Bazamenti i saj është gjysmë shkëmbor (tokë). Lartësia e digës nga kurora deri në pikën më të ulët të gërmimit është 17m. Ndërsa gjatësia e kurorës së digës është 600m. Diga ka krijuar një rezervuar në nivelin normal 117.25 m të barabartë me 2 560 000 m³ ujë. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit është 356 000 m². Pellgu Ujëmbledhës i Liqenit Artificial të Tiranës -ka një sipërfaqe rreth 5 km² dhe shtrihet në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, rreth 2 km larg qendrës së tij. Ai konturohet nga vargu i kodrave të Saukut. Pjerrësia e shpateve varion minimumi rreth 5% deri maksimumi rreth 40% me pjerrësi mesatare rreth 20%. Pellgu Ujëmbledhës i Liqenit pjesërisht është i pyllëzuar dhe pjesërisht me toka të punueshme. Lartësitë minimale dhe maksimale të Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit variojnë nga kuota 120 m deri në kuotën 330 m, me kuotë mesatare rreth 170 m. Zona e ujëmbledhësit të Liqenit Artificial të Tiranës bën pjesë në zonën mesdhetare fushore qendrore. Temperaturat mesatare mujore lëkundën nga 3° C deri në rreth 30° C në muajt e verës. Në këtë pellg bien rreth 1250 mm reshje në vit. Regjimi i reshjeve është mesdhetar me sasinë më të madhe të reshjeve gjatë vjeshtës dhe dimrit. Rrjedhja në pellgun e Liqenit Artificial të Tiranës krijohet nga reshjet e shiut. Prurja mesatare shumëvjeçare në aksin e digës është rreth 80 litra /sek. Plota formohet për 30 minuta. Liqeni i Tiranës ka vetëm funksion ekologjik, duke ruajtur nivel konstant gjatë gjithë vitit të pasqyrës së ujit. Në digën e e Liqenit Artificial të Tiranës nuk ka instrument për matjen automatike të nivelit të ujit në liqen. Matjet janë bërë çdo ditë me metër (latë të vendosur në faqen e Veprës së shkarkimit. Në ditët me prurje të mëdha niveli është matur disa herë në ditë.

3.1.1 Analiza hidrogeologjike

Ne varesi të tipareve litologjike dhe të vetive hidrogeologjike të tyre dallohen këto komplekse ujëmbajtëse në zonën e Tiranës :

- Kompleksi i shkëmbinjeve kalimtare (Shlire)
- Kompleksi i shkëmbinjeve mollasik
- Kompleksi i depozitimeve të kuaternarit

Kompleksi i shkëmbinjeve kalimtare (Shlire) Në pikpamjen hidrogeologjike është shumë i varfer, pra me ujëmbajtje shumë të ulët.

Kompleksi mollasik

Në lidhje me ujëmbajtjen kompleksi mollasik kemi formacione me ujëmbajtje të vogël (burimet e ujit të rrallë 0.011/sek- 0.05 1/sek deri 0.21/sek). Në këtë grup hyjnë formacioni i suites Mezezi, Skutera, Preza, Peza dhe suita Priska

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të kuaternarit Në varesi të gjenezës dhe të përberjes

litologjike kompleksi i depozitimeve te.kuaternarit ndahet ne:

- Depozitime aluviale
- Depozitime eluviale- deluviale
- Depozitime aluviale-kenetore-deluviale

Depozitimet aluviale zene pjesen mete madhe te zones se Tiranës dhe brenda tyre vecohen dy horizonte ujembajtesese:

- Horizonti i ujrave freatik
- Horizonti i ujrave me presion subartezian te zhavoneve te varrosura lumore

3.1.2 Analiza hidrografike

Sistemi kryesor lumor është i përbërë nga 1) Lumi Tërkuzë, që rrjedh në pjesën veriore të Tiranës dhe derdhet në lumenjtë Tirana dhe Ishmi, dhe 2) Lumi Tirana, që kalon nëpër qytet nga lindja në perëndim. Dy sisteme të vogla lumenjsh, dmth, lumi i Limuthit dhe lumi Lana, që kalon përmes qendrës së qytetit, të dy sistemet derdhen në lumin Tirana. Është dhe Lumi Erzen, i cili rrjedh në jug të qytetit dhe derdhet në detin Adriatik.Ultësira e Tiranë-Ishmit, ka si kontur jugor lumin Lana, kurse si kontur verior luginën e lumit Ishëm.

3.1.3 Fluksi i ujit ne veshtrim rajonal

Rajoni ne studim eshte i pasur me ujera nentokesore dhe siperfaqesore. Lumi kryesor që përshkon zonën Tiranë-Ishëm është Lumi Ishëm i cili është pjesë e pellgut hidrografik Erzen-Ishëm. Karakteristikat kryesore hidrografike të Lumit Ishëm janë: është i gjatë 75 km, lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 357 m ndërsa sipërfaqja e pellgut të tij ujëmbledhës është 673 km² (Kabo M., etj, 1990). Lumi-Ishëm përshkon gjithë luginën me degët e tij: Lana, Tirana, Tërkuzat të cilët në fshatin Larushk formojnë Lumin-Gjola. Më tej, Lumi Zeza së bashku me Lumin Gjola në fshatin Bilaj formojnë Lumin Ishëm. Delta e Lumit Ishëm ndodhet në Kepin e Rodonit.

3.1.4 Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon per bilancin e prodhimit te ujit nga burime siperfaqesore dhe nentokesore ne territorin e bashkise Tirane dhe sasine e konsumit te tij. Uji perdoret per qellime teknologjike, per pirje, imbotilim (mbushje e shisheve me uje), shpemdardje nepermjet rrjetit te ujesjellesit dhe perdorim nga banoret, bizneset, industrite, institucionet etj. Per te here nje llogaritje te perafert te sasise se ujit qe ndodhet ne organizmin urban (ne kete rast, territorin e bashkise Tirane) mund te marrim sasine totale te ujrave ne territor (burime siperfaqesore dhe nentokesore) dhe sasine e perdorimit te ujrave. Sasia e ujrave nentokesore llogaritet nga burimet qe shfrytezohen ne territor. Sasia e ujit qe shfrytezohet nga burimet ujore eshte nga 2 l/sek . Keto ujera nentokesore perdoren per pirje, per t'u shperndare ne sistemin e ujesjellesit, per qellime teknologjike etj.

3.1.5 Burimet ujore siperfaqesore

Bashkia e Tiranës ka një rrjet të pasur ujor. Fusha e Tiranës ka dhe disa liqene të vegjël artificial të cilët janë liqenet e Kasharit, Farkës dhe liqeni artificial i Tiranës.

Zona e ujëmbledhësit të Liqenit Artificial të Tiranës bën pjesë në zonën mesdhetare fushore qëndrore. Temperaturat mesatare mujore lëkunden nga 3° C deri në rreth 30° C në muajt e verës. Në këtë pellg bien rreth 1250 mm reshje në vit. Regjimi i reshjeve është mesdhetar me sasinë më të madhe të reshjeve gjatë vjeshtës dhe dimrit. Rrjedhja në pellgun e Liqenit Artificial të Tiranës krijohet nga reshjet e shiut. Prurja mesatare shumëvjeçare në aksin e digës është rreth 80 litra /sek. Plota formohet për 30 minuta. Liqeni i Tiranës ka vetëm funksion ekologjik, duke ruajtur nivel konstant gjatë gjithë vitit të pasqyrës së ujit. Në digën e Liqenit Artificial të Tiranës nuk ka instrument për matjen automatike të nivelit të ujit në liqen. Matjet janë bërë çdo ditë me metër (latë të vendosur në faqen e Veprës së shkarkimit). Në ditët me prurje të mëdha niveli është matur disa herë në ditë. Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Tiranë, e ka marrë Digën e Liqenit Artificial të Tiranës, me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës me datë 03.08.2015.

Liqeni i Farkës. Terreni përreth Liqenit të Farkës ndodhet në pjesën jugore dhe jugperëndimore të qytetit të Tiranës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 11 mijë metra katrorë dhe ka një gjatësi prej 760 metra linearë. Liqeni i Farkës ndodhet 9.6 km nga qendra e Tiranës dhe vetëm 2.3 km nga rruga nacionale gjë e cila e bën këtë park lehtësisht të arritshëm për vizitorët. Kjo zonë dallohet për biodiversitetin dhe peisazhin tërheqës kodrinor si dhe trashëgiminë natyrore. Pjesë e kësaj trashëgimie janë objekte, peisazhe, ekosisteme, habitate të veçanta, të rralla dhe unikale, relikte, lloje endemike apo të rrezikuara për t'u zhdukur. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe ekologjike, shkencore, kulturore, didaktike, por edhe turistike, prandaj duhet të ruhen dhe mbrohen me forma e mënyra shumë të rrepta, të përcaktuara saktë dhe prerë në ligje të veçanta. Për vlerat e lartpërmendura propozojmë që zona përreth liqenit të mbrohet duke i dhënë statusin Park Rekreativ.

3.1.6 Burimet ujore nentokesore

Ujërat e shkëmbinjve më të vjetër (rrënjësorë) dhe formimeve më të reja kuaternare që mbulojnë ultësirën e madhe me shtrirje prej Qafë-Krrabës dhe deri në bregdetin Adriatik, përbëjnë pellgun e madh të ujerave nentokesore të cilësuar "Pellgu artezian ndërmaalor" i Tiranë-Ishmit. Zona e Tiranës nga pikëpamja hidrodinamike përbën kryesisht zonën e ushqimit dhe zonën e presionit piezometrik të këtij pellgu, ku dalin në pah ujerave nentokesore të depozitimeve më të reja aluviale të kuaternarit që përbëjnë njëkohësisht kolektorët më të fuqishëm ujëmbajtës të rajonit Tiranë-Ishëm (Keta Z., 1969).

Në përgjithësi pellgu ujëmbajtës formohet nga depozitime të shkëmbinjve kompaktë dhe nga depozitime të shkëmbinjve të shkrifët porozë të cilët kushtëzojnë edhe dallimin esencial të komplekseve hidrogeologjike të pellgut. Ai përfaqëson një depresion të mbushur me depozitime kuaternare kryesisht zhavorre e më pak zhure (Sektori Adriatik), me mbulesë suargjile, surëra e argjila plastike sidomos me rritjen e trashësisë së saj në Fushë-Krujë - Ishëm. Bazamenti i depozitimeve kuaternare si dhe anët e gjithë

depresionit janë depozitimet e tortonianit me suita argjilore e ranore ku poshtë tyre e në krahun verilindor edhe në sipërfaqe janë gëlqerorët e kretak-paleogjenit.

Ujerat nentokesore të depozitimeve të pakove dhe nënkateve të ndryshme të moshave më të vjetra të tortonianit dhe të mesinianit paraqesin përafërsi të madhe midis tyre, karakteristika hidrogeologjike pothuajse të njëjta, por treguesit hidrodinamikë të tyre janë të ulët dhe rezervat shumë më të vogla se ato të depozitimeve kuaternare (Keta Z., 1969). Bazuar në Hartën Hidrogeologjike shkallë 1:200000 (1983) është ndërtuar “Harta hidrogeologjike e pellgut ujëmbajtës Tiranë-Ishëm” në shkallë 1: 50000 ku janë paraqitur të gjitha formacionet ujëmbajtëse me moshat përkatëse (figura 13). Në hartën hidrogeologjike shk 1 : 50 000, jepet drejtimi i rrjedhjes së ujit si dhe izolinjat e sipërfaqes piezometrike të shtresës zhavorrore për shtresën ujëmbajtëse poroze me përshkueshmëri të lartë.



4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEE TË MUNDSHME

4.1 METODOLOGJIA PER IDENTIFIKIMIN DHE ANALIZEN E NDIKIMEVE

Përshkrimi i një ndikimi të mundshëm përfshin një vlerësim të karakteristikave të tij, së bashku me atributet e mjedisit pritës. Karakteristikat perkatese të ndikimit përfshijne nëse ndikimi është:

- Negativ apo i dobishëm;
- I drejtpërdrejtë ose i tërthortë;
- Afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë në kohëzgjatje; dhe i përhershëm ose i përkohshëm;
- Me ndikim në shkallë lokale, rajonale ose globale; përfshirë edhe ndikimin ndërkuftar;
- Kumulative (Një ndikim kumulativ është "ndikimi në mjedis që rezulton nga rritja e ndikimit të një veprimit, kur shtohet mbi veprime të tjera të ndodhura në të kaluarën, tashmen apo dhe të veprimeve të arsyeshme të parashikuara të ndodhin në të ardhmen").

Secila nga këto karakteristika është diskutuar për çdo ndikim. Marrja në konsideratë e treguesve të mësipërm jep një ndjenjë të intensitetit relativ të ndikimit. Ndjeshmëria e mjedisit pritës u përcaktua nga specialistët bazuar në të dhënat bazë të mbledhura gjatë studimit.

Çdo ndikim është vlerësuar duke përdorur kriteret e renditura në tabelën e mëposhtme. Për të siguruar një ilustrim relativ shkallës së ndikimit, është e dobishme që të caktohen përshkrues numerike ose relativë të intensitetit të ndikimit dhe ndjeshmëria e receptorit për çdo ndikim të mundshëm. Secili kriter është vlerësuar në një shkallë numerike 1, 2, 3, ose 4, që korrespondon me nivelet: shumë të ulët, të ulët, të mesëm ose të lartë. Shkalla (ashpërsia) e ndikimit është llogaritur më pas si produkti i dy përshkruesve numerike, duke e përshkruar shkallën (ashpërsinë) e ndikimit si të papërfillshme, të vogël, të moderuar apo të madhe. Kjo është një metodë cilësore e projektuar për të siguruar një renditje të gjerë të ndikimeve të ndryshme të një projekti. Në tabelë janë dhënë ilustrime të llojeve të ndikimit që marrin vlera të ndryshme të ashpërsisë.

	Klasifikimi	Pershkrimi
1	Shtrirja:	Vlerësimi i zonës së shfaqjes/influences të ndikimit mbi mjedisin në fjale; nëse ndikimi do të ndodhë në vend, në një zonë të kufizuar (brenda një rrezeje prej 2 km nga vendi i projektit); në nivel lokal (brenda një rrezeje prej 5 km); rajonal (nivel qarku, kombëtar ose ndërkombëtar).
2	Vazhdimesia/ Kohezgjatja:	Vlerësimi i kohëzgjatjes së ndikimit në mjedis, nëse ndikimi ka qenë i përkohshëm (<1 vit); afat-shkurtër (1 - 5 vjet); afatmesëm (5 - 10 vjet); afatgjatë (> 10); ose i përhershëm.
3	Konteksti social/ Ndjeshmeria ose Potenciali për konflikt ndermjet aktorëve:	Vlerësimi i ndikimeve për receptorët e ndjeshëm në aspektin e ndjeshmërisë ekologjike, sociale dhe aspekteve të tilla si specie të rralla dhe të rrezikuara, mjedise sensitive ekologjike dhe të rrezikuara, arkitekturë, mjedis shoqëror ose kulturor, potencial i madh për konflikte interesash të aktoreve të ndryshme.

3		<p>Klasifikimi i ndjeshmërisë është paraqitur më poshtë:</p> <p><i>Ndjeshmëri e lartë:</i> Zhvendosje e gjithë komunitetit, shkatërrim i trashëgimisë botërore apo vendeve të rëndësishme kulturore, konflikt në shkallë të madhe të grupeve të interesit, etj</p> <p><i>Ndjeshmëri Mesatare:</i> Zhvendosja e disa familjeve, niveli i moderuar i shqetësimit të palëve të interesuara</p> <p><i>Ndjeshmëri e ulët:</i> Nuk janë te nevojshme zhvendosjet, nuk ka potencial për konflikt të palëve të interesuara.</p>
4	Pajtueshmëria me kerkesat ligjore dhe kuadrin rregullator	<p>Vlerësimi i ndikimit ndaj kërkesave ligjore kombetare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>E lartë:</i> Shkelje të mëdha të kërkesave rregullative që mund të rezultojnë në ndjekje penale ose vonesa të mëdha në miratimin e projektit.</p> <p><i>Mesatare:</i> Shkelje potenciale të kufijve specifike të kuadrin rregullator që mund të rezultojnë në mospërputhje.</p> <p><i>E ulët:</i> Nuk parashikohen shkelje të kufijve të veçantë të kuadrin rregullator.</p>
5	Vlerësimi i Ndikimit në përgjithësi (Rendësia):	<p>Duke përdorur një kombinim të kriterëve të mësipërme, rëndësia e përgjithshme e ndikimit është kategorizuar si: shumë e madhe, e moderuar, e vogël dhe e papërfillshme.</p>

Klasifikimi i vlerësimit të ndikimeve në mjedis

Shënim: Këto janë vetëm udhëzime që do të përbëjnë gjykimin profesional që kërkohet në çdo rast individual.

Rëndësia e ndikimit është përcaktuar nepërmjet një matrice të rëndësise se ndikimit e cila krahason peshën e ndikimit me probabilitetin e ndodhjes së tij. Kriteret e rëndësise se ndikimit janë si më poshtë:

- *Shumë e Lartë (VH) dhe i lartë (H):* Këto tregojnë se ndikimi është i papranueshëm dhe se duhet të zbatohen masa të tjera zbutëse për të zvogëluar rëndësinë.
- *Mesatare (M):* Ndikimet në këtë rajon konsiderohen të tolerueshme por duhet të bëhen përpjekje për të reduktuar ndikimin në nivele që janë aq të ulëta sa gjykohen si praktikisht të arsyeshme.
- *E ulët (L):* Ndikimet në këtë rajon janë konsideruar të pranueshme.

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shume e ulet	E ulet	Mesatare	E larte
			1	2	3	4
Intesiteti i ndikimit	Shume e ulet	1	1 I paperfillshem	2 I vogel	3 I vogel	4 I vogel
	E ulet	2	2 I vogel	4 I vogel	6 I moderuar	8 I moderuar
	Mesatar e	3	3 I vogel	6 I moderuar	9 I moderuar	12 I madh
	E larte	4	4 I vogel	8 I moderuar	12 I madh	16 I madh

Percaktimi i rëndësise se ndikimit

Efektet kumulative vihen re kur kushtet socio-mjedisore janë tashmë ndikuar nga zhvillimet e kaluara ose me shumë të ngjarë do të ndikohen nga zhvillime apo aktivitete që është e mundshme të zhvillohen në të ardhmen. Në këtë VNM janë identifikuar aktivitete të së kaluarës, aktuale, dhe aktivitete të ngjashme që mund të komplikojnë kushtet socio-mjedisore në zonën e projektit.

Masat zbutëse janë planifikuar për të shmangur, reduktuar, zbutur apo kompensuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale dhe janë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM).

4.2 NDIKIMI GJATE FAZES SE ZBATIMIT/NDERTIMIT

4.2.1 Ndikimi social

Të ardhura më të larta për kontraktorët dhe për furnitorët e materialeve: Zhvillimi i projektit nënkupton punimet civile që kërkojnë materiale të tilla si zhavorr, pllaka, lëndë druri, hekur dhe çimento. Ky ndikim është pozitiv, por afatshkurtër dhe ndikimi i kthyeshëm. Duke pasur parasysh se puna ndërtimore do të jetë lokale apo kombëtare, ky ndikim ka shtrirje lokale apo kombëtare.

Masat përmirësuese: Lëndët e para (materialet e ndërtimit) duhet të merren vetëm nga subjekte të licensuara. Materialet e ndërtimit të cilat do të përdoren, do të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Blerja e vetëdijshme ose i paqëllimtë e këtyre materialeve nga operatorë të palicencuar në mënyrë indirekte nxit degradimin e mjedisit në zonat ku janë vendosur këto subjekte të paligjshme dhe mund të shpjerë në ndikime negative afatmesme apo afatgjata. Prandaj, blerja e materialeve të ndërtimit nga guroret e licencuara dhe që operojnë në mënyrë legjitime duhet të jetë një detyrim kontraktual për kontraktorët.

Punesimi: Ndërtimi do të ofrojë mundësi si të punonjesit e kualifikuar ashtu edhe për fuqi punëtore të pakualifikuar. Ky do të jetë një ndikim pozitiv, por afatshkurtër dhe i kthyeshëm, që zgjat vetëm gjatë periudhës së ndërtimit (implementimit të projektit).

Masat përmirësuese: Kurdo që të jetë e mundur, duhet të konsiderohet mundësia e punësimit e banorëve lokale, kjo në varësi të nivelit të aftësive të tyre. Për të siguruar një mjedis të favorshëm për punën është e domosdoshme që për punonjesit të ofrohen standardet perkatese të shëndetit dhe sigurisë në punë.

4.2.2 Ndikimet fizike me ndryshime në topografinë lokale

Identifikimi i ndikimit: Zbatimi i këtij projekti do të përfshijë aktivitete të ndryshme. Gjate kesaj faze nuk do të ketë ndryshime të medha në topografinë lokale pasi në përgjithësi sheshi ka pjerresi të ulet. Në projekt është parashikuar një radhe dhe drejtim i tillë organizimi, që në kombinim me masat e tjera suplementare si të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë ndryshime topografike. Përse i perket ndikimeve nga efekti i erozionit, zona nuk është e predispozuar ndaj erozionit në sipërfaqe, i cili është në nivele të paperfillshme. Ky fenomen mund të haset gjatë germimit të dheut. Për të parandaluar këto fenomene (në rast se e hasim gjatë germimit të dheut) duhen marrim masa në mënyrë që të sigurohen të gjithë veprimet e nevojshme që janë parashikuar për të siguruar qëndrueshmërinë e objekteve përreth.

4.2.3 Demtimi i habitateve dhe biodiversitetit

Ekologjia tokësore dhe biodiversiteti mund të ndikohen gjatë përgatitjes së sheshit të projektit si edhe aktiviteve të ndërtimit dhe operimit. Mund të preket gjithashtu nga shfaqja e ngjarjeve jo rutinore. Ndikimet mund të vijnë nga aspektet e mëposhtme mjedisore:

- Transporti dhe përdorimi i pajisjeve;
- Gërmime dhe punime tokësore për ndërtim;
- Hedhja e mbeturinave gjatë ndërtimit dhe operimit;
- Ngjarje aksidentale (jo-rutinore): derdhje dhe rrjedhje e vajrave dhe naftes;
- Ngjarje aksidentale (jo-rutinore): asgjësim i papërshtatshëm i mbeturinave

Gjate fazes së zbatimit të projektit mund të ketë sipërfaqe të kufizuara që mund të zhvishen/pastrohen nga vegjetacioni. Por këto do të rigjëlberohen me drure apo shkurre. Perpos kësaj, në përfundim të projektit janë planifikuar të mbillen edhe shumë drure të tjera, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në balancën e nivelit të CO₂ në atmosferë.

Gjatë fazës operative, aktivitetet në zonën e projektit do të çojnë në një rritje të mbeturinave dhe mbetjeve të ngurta. Mbetjet e ngurta, të krijuara nga aktivitetet e funksionimit, mund të ndikojnë negativisht në një numër të KVE- (Komponentëve më me Vlerë të Ekosistemit), përfshirë gjitarët dhe bimësinë.

Ngjarjet aksidentale gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projektit mund të përfshijnë zjarret, derdhje të karburantit, etj. Planet e reagimit emergjent do të jenë në vend për të lehtësuar çdo ngjarje aksidentale.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Për humbjen e habitatit si rezultat i aktiviteve të ndërtimit nuk ka asnjë masë specifike; megjithatë, ripopullimi ka të ngjarë të ndodhë në zonat që nuk i nënshtrohen shqetësimeve të vazhdueshme të lidhura me funksionimin e zonës së projektit.
- ii) Pastrimi i përgjithshëm duhet të jetë i vazhdueshëm për të parandaluar krijimin e pirgjeve me mbeturina apo që mbeturinat që lidhen me aktivitetet në zonën e projektit të përhapen në të gjithë zonën dhe zonën ngjitur.
- iii) Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin tek gjitarët dhe zogjtë.
- iv) Përdorimi i bimëve vendase për peizazhet përgjatë korridoreve duhet të ketë përparësi ndaj llojeve të introduktuara.
- v) dhe pajisjet duhet të mirëmbahen për të minimizuar emetimet dhe rrjedhjet e panevojshme.
- vi) Për të minimizuar shkatërrimin e habitatit nga udhëtimet jashtë trupit të rrugës duhet të përdoren rrugët dhe gjurmët ekzistuese.

4.2.4 Ndikimi negativ në mjedis

Identifikimi i ndikimit: Projekti për rikualifikimin e bllokut të Tregu Çam, do të përfshijë disa aktivitete që mund të gjenerojnë mbetje inerte të konsiderueshme të përbërë nga metale, beton, qelq, gur dhe mbeturina druri. Këtu përfshihen punimet për:

- Riaftesimin e shtresave rrugore
- Rikonstruksionin e fasadave të tregut
- pajisjen sipas nevojës me kanalizime përgjatë rrugëve duke përfshirë edhe lidhjet me kanalizimet ekzistuese;

- heqjen dhe rivendosjen në kanale nëntokësore e kablllove ajrore ekzistuese përgjatë rrugëve;
- vendosjen e sistemit të ri të ndriçimit me ndriçues të përshtatshëm;

Vlerësimi i ndikimit: Trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit mund të ketë ndikime në mjedis dhe shëndetin publik. Hidrologjia e ujërave sipërfaqesore mund të preken gjatë sistemimit të sheshit për ta bërë gati për ndërtim nëpërmjet gërryerje së materialeve të imta të gjeneruara si rezultat i pastrimit të mbetjeve dhe sipërfaqes të tokës të ekspozuar ndaj shiut dhe kullimit të ujërave. Keto mund të depozitohen në rrjedhat e ujit dhe ndryshojnë natyrën e shtratit të përrrenjëve.

Rëndësia e ndikimit: largimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit mund të ketë ndikime afat-mesme apo afatgjatë në mjedis dhe shëndetin publik. Shtrirja e këtij ndikimi do të jetë lokale në zonat ku do të hidhen mbetjet, apo në lagjet në afërsi. Mundësia që ky ndikim të ndodhi është E lartë duke patur parasysh mungesën e objekteve që trajtojnë mbetjet e ndërtimit. Nëse hidhen në vende të papërshtatshme mbetjet e ndërtimit ndotin burimet mjedisore (tokën dhe ujin) apo shkaktojnë efekte në shëndetin publik, ndaj edhe rëndësia e këtij ndikimi do të jetë E lartë.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Kontraktorët duhet të bëjnë kategorizimin e mbetjeve në burim për të ndarë mbetjet e rrezikshme nga ato të pa rrezikshme;
- Percaktimi i rrugës dhe kohës së qarkullimit të kamionëve të rëndë që transportojnë mbeturinat nga shembja e godinës në mënyrë që të shmangen zonat e banuara ose receptorë të tjerë të ndjeshëm njerëzorë sa më shumë të jetë e mundur;
- mbetjet duhet të largohen nga sheshi të paktën një herë në 24 orë dhe kur mbahen përkohësisht në vend duhet të mbulohen për të minimizuar aromën e pakëndshme dhe parazitët;
- Kontraktori do të punojë së bashku me Bashkinë për të lehtësuar trajtimin e duhur dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi. Të gjitha mbetjet duhet të hidhen në deponitë e miratuara;
- Mbeturinat e rrezikshme të tilla si bojerat, çimento, adhezivët do të menaxhohen përmes një pale të tretë (kontraktor) të certifikuar nga AKM-ja. Bashkia dhe kontraktori do të punojnë së bashku për të lehtësuar trajtimin e sigurtë dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi;
- inxhinierët mbikëqyres (supervizori) dhe inspektorët e agjensisë rajonale të mjedisore duhet të sigurohen se kontraktuesit nuk i hedhin mbetjet në mënyrë të paligjshme në zonat të tjera jashtë atyre të caktuara. Inspektorët e mjedisit nga ARM duhet të ndërmarrin rolin aktiv për monitorimin gjatë periudhës së ndërtimit;
- duhet të krijohet dhe të zbatohet mekanizmi i ankesave për të adresuar shqetësimet dhe ankesat mundshme nga komuniteti.

4.2.5 Ndikimet e mundshme në peisazh dhe anën vizuale

Fokusi i vlerësimit të ndikimit në peisazh dhe në pamjen vizuale të zonës të projektit kanë qenë: efektet e vecanta në modelin e përgjithshëm të elementeve të peisazhit që krijojnë karakterin e peisazhit dhe dallueshmërinë lokale dhe rajonale; apo zonat me interes ose vlera të veçanta siç janë zonat me domethënie të veçantë peisazhi .

Ne fazen e ndërtimit do të linde nevoja për vendosjen e materialeve, pajisjeve apo dhe kordonëve për rrethimin e sheshit të ndërtimit. Ndikimi në peizazh dhe në anën vizuale do të jetë i lartë sepse përveç rikualifikimit të rrugëve dhe të fasadave zona e ndërtimit do të preket edhe nga ana e sistemit të jashtëm duke futur mbjelljen e pemëve, shkurreve dhe shtimit e hapësirave të gjelbra. Kjo do ndikojë shumë mirë në peizazh dhe në pamjen vizuale duke i dhënë një karakter zones duke qenë se tani është e pa organizuar.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktuesi duhet të sigurojë që gjurma e lenë nga aktivitetet e ndërtimit të jetë minimale.

4.2.6 Presioni mbi burimet (lendet e para) ekzistuese

Gjatë fazës së ndërtimit, kërkesa për lendet e para baze të tilla si uji dhe energjia elektrike mund të ushtrojë presion mbi infrastrukturën ekzistuese.

Duke pasur parasysh natyrën e projektit, intensiteti i ndikimit do të jetë i ulët dhe afat-shkurtër dhe i kufizuar vetëm gjatë fazes së ndërtimit. Megjithatë, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë e lartë, duke dhënë një ndikim me rëndësi të moderuar.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktuesi duhet të sigurojë vend (depozitë) të veçantë për ujin që do të përdoret në ndërtim. Në vend që të lidhet me sistemin e furnizimit me ujë të zonës, kontraktori duhet të zgjedhi të përdorë ujë nga depozitat për furnizimin me ujë.

4.2.7 Gjenerimi i zhurmave dhe vibrimeve

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga përdorimi i fadronave, gjeneratoreve, matrapikeve, zhurma e prodhuar nga vetë personat që do të punojnë në atë shesh, proceset e hedhjes së betonit, përdorimi i skelave dhe derrasave, pajisjeve të prerjes së hekurit, etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedisë ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit. Kjo duhet të kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Duke qenë se zona e ndërtimit është afër qendrës së banuar do të ketë shqetësime për banorët e zonës.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Zhurma operationale është e lidhur me funksionimin. Gjatë funksionimit nuk ka burime potenciale të zhurmave pasi përdorimi normal i këtyre objekteve të rikualifikuara nuk rezulton që mund të shpjerë në rritje nivelit të zhurmës. Në rast të verpimtarive që gjenerojnë duhet të merren masa të përshtatshme për minimizimin e tyre për të cilat ka mundësi të shumta e përvoja të njohura për t'u zbatuar.

Reagimi i njerëzve ndaj vibracioneve në terren ndikohet nga shumë faktorë fizike, si amplituda, kohëzgjatja dhe përmbajtja e frekuencave të vibracioneve, si dhe faktorë të tjerë si lloji i popullsisë, mosha, gjinia dhe pritjet të cilat janë fiziologjike. Në këtë mënyrë reagimi i njerëzve për vibracionet është subjektiv dhe kjo ndryshon për njerëz të ndryshëm. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet e dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme.

4.2.8 Trafiku dhe emertimet qe lidhen me të

Emetimet e lindura nga trafiku përfshijnë pluhurin dhe tymrat. Emetimet e pluhurit do të dalin nga aktivitetet e ndërtimit dhe trafiku i mjeteve të ndërtimit. Kamionët e përdorur për të transportuar materiale të ndryshme ndërtimi nga burimi i tyre për në sheshin e ndërtimit të objektit emetojnë gazra të ndryshem si SO₂, CO₂, CO, NO_x dhe grimca. Ndikimet e emetimeve të tilla mund të jenë më të medha në vendin e ndërtimit dhe në komunitetet ndërmjet te cilave do të udhëtojnë automjetet e ndërtimit. Receptorët e ndikimit përfshijnë komunitetet përgjatë rrugëve të transportit, dyqanet dhe tregjet anës rrugëve, punëtorët e ndërtimit.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 I papërfillshëm	2 I vogël	3 I vogël	4 I vogël
	E ulët	2	2 I vogël	4 I vogël	6 I moderuar	8 I moderuar
	Mesatare	3	3 I vogël	6 I moderuar	9 I moderuar	12 I madh
	E lartë	4	4 I vogël	8 I moderuar	12 I madh	16 I madh

Në çdo rast, pavarësisht nga proceset që do të kryhen, cilësia e ajrit nuk do të çenohet jasht standarteve të parashikuara. Kësisoj, pritshmerite jane qe cilesia e ajrit mund te çenohet më shumë gjate proceseve të zhvendosjes se mbeturinave të ndërtimit dhe dherave të dale nga gërmimi i trupit të rrugëve, sidomos nese këto procese do të kryheshin në stinën e thatë të verës. Ne literaturen teknike jepet vlera reference 0.15-0.30 kg/ m³ muaj per clirimet e pluhurave qe perhapen ne mjedis. Keto çlirime mund te konsiderohen te pranueshme. Rikthimi i pluhurit ne toke, ne fakt, supozohet se do te jete shume i vogel dhe do te ndodhe vetem ne zonen prane sheshit të ndërtimit, keshtu qe nuk do te shkaktoje shqetësime mbetese për zonën rretheqark.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Aktivitetet e ndërtimit do të kryhen gjatë ditës.
- Do të mbahet nen kontroll shpejtësia e udhëtimit te automjeteve të ndërtimit;
- Kamionet do te mbulohen gjatë transportimit të materialeve të ndërtimit;
- Kurdo që është e nevojshme, zonat me pluhur dhe ato gjeneruese të pluhurit do të spërkaten apo lagen me ujë;
- Pajisjet e ndërtimit do të mbahen në gjendje të mirë operative për të reduktuar emetimet e gazrave;
- Të gjitha makinerite para se të largohen nga sheshi, duhet të pastrojnë gomat e tyre në rast se ato janë të papastër;
- Punëtorët do të pajisen me Pajisje Mbrojtëse Personale dhe do të zbatohet përdorimi i tyre.

- viii) Implementimi i projektit duhet të ndërmerret nga një kontraktor me përvojë dhe me një ndjenjë të verifikueshme ndërgjegjësimit dhe përgjegjësie mjedisore.
- ix) Zona e projektit do të jetë e rrethuar për të minimizuar migrimin e pluhurit për në objektet e afërta.

Autoriteti	Ndotësit	Vlerat mesatare të elementëve ndotës						
		SO ₂			NO _x			
		Vjetore	24 h MAX	Ditore	Vjetore	24 orë Max	Ditore	Orare
Banka Boterore		0.10	0.5 (jasht)	1.0 (brenda)	0.05 ppm	-	0.05	-
SHBA		0.02ppm [a] 0.03ppm [b]	0.1ppm [a] 0.14ppm [b] 0.5ppm [ac]	-	0.05 ppm	-	-	-
WHO		-	90µg/m ³	-	-	-	-	190-320 µg/m ³
UE		80 µg/m ³	-	-	200 µg/m ³	-	-	-

Standartet e cilesise se ajrit dhe shkarkimet ndotese ne mjedis

4.2.9 Siguria dhe shendetit ne pune

Aktivitetet e planifikuara në kuader të këtij projekti mund të paraqesin rreziqe pontenciale disa prej të cilave mund të jenë të rrezikshme për jetën. Puna me tension të lartë apo pune me nxehtësi (sikurse saldimit), përbëjnë një rrezik për dëmtime nga elektriciteti. Lëndime ose demtime të shtylles kurrizore mund të ndodhin në qoftë se punëtorët mbajnë objekte të rënda. Rreziqe të tjera të mundshme mund të jenë: ndriçimi joadekuat ose nivel të kufizuar të shikimit gjatë fortunave duke krijuar vështirësi për stafin e makinerive të pajisjeve të rënda, makinave me sistem të papërshtatshëm frenimi, mungesë përqëndrimi ndërsa punohet dhe ekspozimin ndaj mbetjeve të rrezikshme të tilla si bojrat, çimento, adhezive dhe tretësit për pastrim. Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë afatshkurtër pasi mund të ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

Udhëzimet e Bankës Botërore dhe legjislacioni Shqiptar kërkojnë që punëtorët e ekspozuar ndaj niveleve të zhurmës më të larta se 80 dB (A), për një kohëzgjatje prej më shumë se 8 orë në ditë duhet të përdorin mbrojtëse për organet e degjimit.

Mundësia e ndodhjes së këtij ndikimi do të jetë e vogël duke pasur parasysh nivelin e sigurisë në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe tipologjinë e nderhyrjeve të planifikuara.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Trajnimit të gjithë punëtorëve të ndërtimit lidhur me praktikën dhe udhëzimet për sigurinë në punë dhe kontrollin e vazhdueshëm që ata t'i përmbahen atyre.
- Trajnimit do të kryhet si për të parandaluar ashtu dhe për të menaxhuar incidentet. Trajnimi duhet të përfshijë trajtimin e duhur lidhur me mënyrën se si të reagojnë kur ka probleme me energjinë elektrike, ujin, etj., dhe sensibilizimin për mënyrat e ndryshme të sjelljes dhe përgjegjësisë gjatë incidenteve të tilla.

- iii. Për të paralajmëruar stafin dhe / ose vizitorët që nuk janë të përfshirë në aktivitetet e ndërtimit lidhur me vendet e rrezikshme, duhet të përdoren tabelat sinjalizuese.
- iv. Mbikëqyrja e punimeve duhet të bëhet rregullisht për të siguruar që janë plotësuar kushtet e sigurisë, ndërsa çdo devijim nga rregullat e sigurisë duhet të përmiresohet menjëherë duke ndjekur praktikën më të mira në lidhje me sigurinë e pajisjeve të punës.
- v. Punëtorëve të ndërtimit duhet tu sigurohen Pajisje Personale Mbrojtëse.

4.2.10 Aksidentet

Zona e projektit ndodhet në një pjesë të populluar të qytetit të Tiranës ku zhvillohen një sërë aktivitetesh tregtare. Me rritjen e numrit të automjeteve të rënda gjatë transportimit të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, do të ketë rritje të rrezikut të aksidenteve apo lëndimeve të lidhura me trafikun. Aksidentet do të kenë një ndikim i rëndësishëm social dhe veçanërisht ka të ngjarë të përfshijnë fëmijë, gra (të cilët zakonisht i kryqëzojnë rrugët me ngadalë se meshkujt), njerëzit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, pa harruar rreziqet që mund të vijnë nga rena poshte e materialeve apo mbeturinave nga aktivitetet e ndërtimit.

Rena e rrethimit apo skelave mund të shkaktojnë aksidente të dëmshme për jetën e njeriut.

Persa i perket kohëzgjatjes ky ndikim do të jetë afatshkurtër dhe do ndodhi vetëm gjatë fazës së zbatimit të projektit. Shtrirja e ndikimit do të jetë lokale. Gjasat që ndikimi të ndodhi janë mesatare duke patur parasysh nivelin e ulët të sigurisë rrugore nga shoferët dhe këmbësorët në Shqipëri. Ndjeshmëria e receptorëve është e lartë pasi disa aksidente mund të çojnë në dëmtime të përhershme dhe të tjerë në humbje të jetës, ndërsa intensiteti i ndikimit është i ulët. Prandaj rëndësia e ndikimit është e moderuar.

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Kontraktori do të miratojë praktikën më të mira të sigurisë të transportit me qëllim parandalimin e aksidenteve në trafik dhe minimizimin e lëndimeve të pësuar nga personeli i projektit dhe publiku, si më poshtë:
 - Kontraktori do të vëre theksin tek siguria nga ana e shoferëve. Në mënyrë të veçantë kontraktori do duhet të sigurohet që shoferët të respektojnë kufijtë e shpejtësisë nëpër zonat me institucione publike;
 - Tabelat sinjalizuese lidhur me trafikun do të jetë të pozicionuara në kryqëzimet e rrugëve për në qendrën spitalore për të kontrolluar shpejtësinë e levizjes së makinave;
- ii) Do të merren masa për kontrollin e trafikut përfshirë përdorimin e shenjave në rrugë dhe personat me flamur që paralajmërojnë KUSHTE TË RREZIKSHME dhe KALIM I FËMIJËVE.
- iii) Kontraktorët të kontrollojnë rregullisht automjetet për të minimizuar aksidentet potencialisht të rënda si psh ato që shkaktohen nga mosfrenimi në kohën e duhur që ndodh me kamionët e mbingarkuar.
- iv) Sheshi i ndërtimit duhet të rrethohet dhe personeli i sigurisë duhet të ndalojë njerëzit e paautorizuar që të futen në objekt.

- v) Gjatë gjithë perimetrit të objektit duhet te vendosen shenja paralajmëruese.
- vi) Veshja e paisjeve mbrojtëse personale do të jetë kusht për punëtorët që janë në sheshin e ndertimit.

4.3 NDIKIMET GJATE FAZES SE FUNKSIONIMIT

4.3.1 Ndikimet sociale

Ky projekt është i rëndësishëm sepse veçante dhe do të shërbejë shumë kryeyetit duke shtuar një pike të re referimi. “Rikualifikimi i bllokut të Tregu Çam” do të jetë një nga ndikimet e mëdha të zonës duke përqendruar vëmendjen e shumë aktiviteteve në këto zone. Ky projekt do të kthejë vëmendjen e banorëve dhe të vizitorëve në këto zone kështu që qytetit të Tiranës.

4.3.2 Përmirësimi i pamjes vizuale dhe rritja e vlerës së pasurisë së paluajtshme

Aktiviteti i propozuar do të ketë një ndikim të madh vizual në estetikën e zonës së projektit duke e përmirësuar ndjeshëm atë.

E gjithë zona do të marrë një pamje tjetër. Shtimi i pjesës së gjelbrë do të ndikojë shumë në zonë si nga ana vizuale dhe mjedisore.

Vlera e pasurisë së paluajtshme në zonë do të peshojë një rritje të konsiderueshme.

4.3.3 Menaxhimi i papershtatshëm i mbetjeve

Si rezultat i ndertimit pritet të gjenerohen mbeturina të ndryshme. Këto mbetje do të jenë të parrezikshme, kryesisht të karakterit të mbeturinave shtëpiake. Grumbullimi, trajtimi dhe deponimi i papershtatshëm i këtyre mbetjeve mund të shkaktojë rreziqe për shëndetin publik për shkak të ndotjes së mjedisit: ndotjes së ajrit, ndotjes së ujit dhe infeksioneve të ndryshme sidomos kur njerëzit kërkojnë mbeturina.

Ndikimi do të jetë afatgjatë dhe mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së projektit. Intensiteti i ndikimit është i ulët nëse Bashkia dhe komuniteti marrin masat e nevojshme për adresimin e tyre. Ndjeshmëria ndaj receptorëve do të jetë e ulët, duke i dhënë ndikime minimale

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- i) Bashkia do të sigurojë koshat e duhur të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave të krijuara për të lejuar ndarjen dhe grumbullimin në pikën e gjenerimit.
- ii) Mbeturinat grumbullohen nga vendi i projektit të paktën një herë në 24 orë, në atë mënyrë që të minimizohen aromat dhe era e keqe, rrëmuja dhe pluhuri.
- iii) Komuniteti lokal do të trainohet ose edukohet mbi rëndësinë dhe mënyrat e administrimit dhe ndarjes së mbeturinave në shtëpi.

4.3.4 Gjenerimi i zhurmave

Pas implementimit të projektit, volumi i zhurmave nga trafiku në zonë dhe përreth pritet të ndryshojë. Për shkak të natyrës logaritmike të zhurmës, një dyfishim i trafikut do të rezultojë në një rritje 3 dBA të niveleve të zhurmës, e cila do të ishte mezi e perceptueshme për veshin e njeriut. Ndërsa trafiku do të rritet në një nivel që është më pak se vëllimet e dyfishta ekzistuese, rritja e zhurmës që rezulton në të gjitha rrugët përreth do të ishte më pak se 3 dBA. Kjo nuk do të rezultojë në një rritje të konsiderueshme të niveleve të zhurmës së ambientit në afërsi të projektit; Prandaj, ndikimi do të ishte më pak se

domethënës dhe nuk kërkohet zbutje.

Duke qene se zona e ndertimit eshte afer zonave te banuara zhurmat e emetuara do te kene ndikim ne jeten e qytetareve te Bashkise Tirane.

Nivelet e zhurmës së ambientit gjatë orëve të vona të natës dhe orëve të para të mëngjesit janë zakonisht në aktivitetet e tyre më të ulëta dhe të zhurmshme, do të ishin më të dukshme, të cilat mund të shqetësojnë paqen ose qetësinë e zones ose të shkaktojnë bezdi te banorët e zones. Zhurma e natës nuk përjashtohet. Bazuar në Ordinancën e Zhurmës, qyteti ndalon zhurmat e panevojshme, të tepërta dhe të bezdisshme nga të gjitha burimet, dhe ato duhet të jenë në përputhje me Ordinancën e Zhurmës. Prandaj, me respektimin e Urdhrit të Zhurmës, ndikimet që lidhen me zhurmën nga oborri i natyrshëm dhe zonat e grënies do të ishin më pak se domethënëse.

5. SHKARKIMET NË MJEDIS

5.1 SHKARKIME E GAZRAVE DHE PLUHURAVE

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojnë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Emetimet në ajër vijnë nga përhapja e pluhurave të materialeve të ndërtimit dhe materialit të gërmuar të sipërfaqes së tokës. Shkarkimet në ajër mund të specifikohen në: emetime të pluhurave dhe grimcave (Dust and Particulates) dhe emetime të gazrave dhe tymrave nga makinat (Gaseous and Exhaust Emissions). Emetimet më të mëdha që çenojnë cilësinë e ajrit mund të ndodhin gjatë orëve të punës në aktivitet ndërtimore.

Pluhuri dhe grimcat

Gjatë ndërtimit, mund të ketë një perkeqesim të përkohshëm të cilësisë së ajrit lokal si rezultat i gjenerimit të pluhurit dhe grimcave. Vleresohet që ky perkeqesim të jetë domethënës, me potencial për të prekur punëtorët në vendndodhjen e projektit.. Krijimi i rrugëve hyrëse, gërmimet dhe punimet tokësore mund të çojë në rritjen e përkohshme të grimcave dhe të pluhurit në ajer nga transporti. Pjesa më e madhe e pluhurit të krijuar gjatë ndërtimit ka të ngjarë të depozitohet brenda 100 metrave nga vendndodhja aktuale e projektit. Në mungesë të të dhënave nga Institucionet Shqiptare, ne përdorëm të dhënat nga Agjensia e Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas Dokumentit të Udhëzimit Teknologjik të Agjencisë së Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar, rreth 85% e grimcave në ajrin e ambientit depozitohen brenda 100 metrave të burimit ndërsa afërsisht 10% depozitohen midis 100 dhe 500 metrave.

Pluhuri nuk shkakton ndryshime afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje por keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës përgatitore dhe asaj të ndërtimit.

Ndërsa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri nëpërmjet erez, grimca të lëshuara edhe nga motorët tëtilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Sasia e emisioneve PM10 është relativisht i vogël, kështu që çdo efekt anësor që rezulton prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efektetë rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit. Cilësia e ajrit gjithashtu do të ulet nga emetimet nga makineritë dhe automjetet e përdorura për transport. Këto emetime nuk pritet të jenë të rëndësishme.

Emetimet e gazrave dhe tymrave

Emetimet e gazrave: Ndotësit kryesorë të cilet janë të lidhur me trafikun rrugor gjatë ndertimit janë NO₂, PM₁₀, CO, benzen (C₆H₆) dhe benzopireni (C₂₀H₁₂). Emetimet e NO₂ dhe PM₁₀ kanë më shumë gjasa për të tejkaluar standardet përkatëse të cilësisë së ajrit për vëndin tonë në objekt ne momente piku të punimeve por jo në numrin e diteve mesatare. Keto emetime do te ndjehen edhe ne mjedisin përiferik ose ngjitur me kantjerin e ndertimit. Nuk parashikohet që ndikimet të shtrihen dhe te perbejnë rrezik potencial për cilësinë e ajrit.

Sasia e Dioksidit te Sqfurit SO₂ në gazrat e emetuar ne ajer varet drejtpërdrejt nga përmbajtja e sqfurit të karburantit të përdorur. Ulja e emetimeve të SO₂ nga motorët mund të zbatohet duke përdorur karburant me përmbajtje të ulët sqfuri për makinerite dhe pajisjet. Kompania qe do zbatoje projektin do të udhëzojë kontraktorët të përdorin karburant me përmbajtje të ulët të sqfurit.

Emetimet e Oksideve te azotit NO_x nga pajisjet/aktivitetet e ndermarra nga kontraktuesit do të duhet të minimizohen. Pajisjet dhe makinerite e ndërtimit mund të kenë nevojë të modifikohen, në masën e nevojshme.

Ndikimet në mjedis gjatë fazes se funksionimit do jene normale dhe lidhen me emetimet nga aktivitet e sherbimeve. Ndikimet zbutese varen nga masat në nivel lokal që lidhen me shkarkimet ne qytet.

Ne rastet kur mund te shkaktohen ndotje te natyrave te ndryshme, do te zbatohet parimi “Ndotsi Pagan”, sikurse eshte saksionuar ne nenin 12 te ligjit Nr. 10431, datë 9 Qershor 2011) “Per mbrojtjen e mjedisit”.

Per te llogaritur vlerat e shkarkimeve ne ajer nga transporti jemi referuar normave te Agjencise Europiane te Mjedisit te botuara ne 2016 (EMEP/EEA Air Pollutant Emission Inventory Guidebook, 2016).

Teknologjia	CO	NMVO C	NO _x	N ₂ O	NH ₃	Pb	CO ₂ lube
	g/km	g/km	g/km	g/km	g/km	g/km	g/km
		E dhene si THC- CH ₄	E dhene si NO ₂ equivalent				Nga vaji lubrifi kues
Konvencionale	2.13	0.776	8.92	0.029	0.0029	9.48E-06	4.86E-01
Euro I - 91/542/EC I	1.02	0.326	5.31	0.008	0.0029	8.36E-06	4.86E-01
Euro II - 91/542/EC II	0.902	0.207	5.50	0.008	0.0029	8.05E-06	4.86E-01
Euro III - 2000	0.972	0.189	4.30	0.004	0.0029	8.39E-06	4.86E-01
Euro IV - 2005	0.071	0.008	2.65	0.012	0.0029	7.85E-06	4.86E-01
Euro V - 2008	0.071	0.008	1.51	0.034	0.011	7.85E-06	4.86E-01
Euro VI	0.071	0.008	0.291	0.033	0.011	7.85E-06	4.86E-01

Normat e shkarkimeve ne ajer nga kamionet 7.5-16 ton.

Duke marrë si referencë një makinë të tipit Euro IV – 2005, një distancë transporti 5 km për kamion në ditë dhe duke llogaritur që në një ditë mund të punojnë 10 kamionë, vlerat e shkarkimit në ajër do të jenë si më poshtë:

CO: $0.071 \times 5 \times 10 = 3.55$ g/ditë

NMVO: $0.008 \times 5 \times 10 = 0.4$ g/ditë

NO_x: $2.65 \times 5 \times 10 = 132.5$ g/ditë

N₂O: $0.012 \times 5 \times 10 = 0.6$ g/ditë

NH₃: $0.029 \times 5 \times 10 = 1.45$ g/ditë

Pb: $7.85E-06 \times 5 \times 10 = 3.92 E-04$ g/ditë CO₂: $4.86E-01 \times 5 \times 10 = 2.43$ g/ditë

Sikurse shihet nga llogaritjet e mësipërme, vlerat e ndotesve kryesore si rrjedhojë e perdorimit të mjeteve të renda të transportit për projektin "Rikualifikimi i bllokut të Tregu Çam"

5.2 MBETJET E NGURTA

Mbetje të ngurta që prodhohen nga ndërtimi në këtë zone do të jenë materiale inerte si llac, beton, pllaka, etj.; mbetje të tjera të ngurta si materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri), si dhe dheu që do të dalë i tepert gjatë germimeve dhe që do të largohen nga sheshi i ndërtimit. Materialet të cilat janë të ripërdorshme, mund t'ju jepen individëve të interesuar për punime ndërtimi në zonat periferike ose rehabilitim të lulishteve ose mbushje të tokave aty ku ka nevojë, pjesa e mbetjeve të pa përdorshme duhet të grumbullohen në vendin e caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes së Lejes së Zhvillimit nga autoritetet përgjegjëse. Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes vendore dhe firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet inerte, apo edhe dheu i gërmuar, materiale të ndërtimit duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Në këtë fazë nuk kemi informacion për mënyrën e menaxhimit të mbetjeve inerte. Landfilli ku do të depozitohen këto mbetje duhet që të jetë i pajisur me leje mjedisore dhe i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Administrata dhe punonjësit e kantierit do t'i kushtojnë vëmendje të vecante edhe këtij aspekti për të parandaluar ndotjen në mjedis nga dispersiteti i mbetjeve të ngurta urbane, mbetjet ndërtimore etj. Në mjediset e kantierit duhet të vendosen kazane të grumbullimit të mbetjeve urbane të krijuara nga veprimtaria e kantierit.

Mbetjet e rrezikshme nëse do të ketë, do të dorëzohen sipas kërkesave të VKM Nr. 371 date 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit"

Vajrat e makinave, nëse do të ketë, do të dorëzohen sipas kërkesave të VKM Nr. 765, date 07.11.2012 "Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorur"

Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme do të shoqërohet me plotësimin e Shtojcës 1 të VKM Nr. 229 date 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"

Baterite e automjeteve klasifikohen si mbetje jashtë përdorimit dhe të rrezikshme do të dorëzohen sipas VKM Nr. 866, date 4.12.2012 "Për Baterite, akumulatoret dhe mbetjet e tyre"

Te gjitha mbetjet teknologjike do të transportohen nga subjekte të pajisur me licence të tipit III.2.B në bazë të ligjit 10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar. Sipas VKM Nr. 575 date 24.06.2015, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Ne kete raport Vleresimi të Ndikimit në Mjedis janë marrë ne konsiderate vetem rrymat e mbetjeve te klasifikuara ne kategorine 17 (Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet -Përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara) të Katalogut Evropian të Mbetjeve (EWC) (që është e njëjta edhe ne Katalogun Shqiptar të Mbetjeve) (KSHM), pasi këto rryma kontribuojnë shume me teper në përqindjen e përgjithshme (për nga pesha) të mbeturinave të gjeneruara në vend. Megjithëse dherat e dale nga gërmimi përfshihen në kapitullin 17 dhe përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të mbetjeve nga ndertimi, në këtë studim nuk janë marrë parasysh për mungesë informacioni. Ekzistojnë disa kode për mbeturinat e ndotura në kapitullin 17, por në këtë studim ato janë përfshirë të gjithë në kodin 17 09 03 pasi nuk kishim informacion të mjaftueshëm për të dalluar mbeturinat e rrezikshme të krijuara në vend.

No	Rryma e mbetjeve	Kodi EWC
1	Betoni	17 01 01
2	Tulla	17 01 02
3	Pllaka dhe qeramikë	17 01 03
4	Përzierja e betonit, tullave, pllakave dhe qeramikës	17 01 07
5	Dru	17 02 01
6	Xhami	17 02 02
7	Plastike	17 02 03
8	Përzierje bituminoze	17 03 02
9	Metale te përziere	17 04 07
10	Materiale izolimi	17 06 04
11	Materiale ndërtimi me bazë gipsi	17 08 02
12	Përzierje mbetjesh ndërtimi dhe prishjeje që përmbajnë substanca të rrezikshme	17 09 03
13	Përzierje mbetjesh ndërtimi dhe prishjeje	17 09 04

Rrymat e mbetjeve dhe Kodi sipas EWC per kategorine 17.

Në përlllogaritjen e sasisë së mundshme të mbetjeve që mund te gjenerohen nga zbatimi i ketij projekti, ne mungesë të studimeve në vendin tonë, jemi bazuar në të dhënat e studimeve të kryera në shume shtete të tjera Europiane. Sasi të mbetjeve që gjenerohen gjatë punimeve të ndërtimit dhe prishjes së objekteve variojnë së pari në varësi të faktit nëse keto janë godina banimi apo komerciale/industriale. Studimet tregojnë gjithashtu që kjo sasi mbetjesh ndyshon nga një studim në tjetrin. Për këtë arsye ne llogaritjen e sasisë së mundshme të mbetjeve që pritet të gjenerohet nga ky projekt kemi marrë një vlerë të ndërmjetme nga këto studime.

5.3 SHKARKIMET NE UJERAT SIPERFAQESORE DHE NENTOKESORE

5.3.1 Ujerat siperfaqesor

Ujerat që dalin nga aktiviteti human në zonë, janë ujëra urbane të cilat do të shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zones. Duhet theksuar që zona e ka pikun e frekuentimit në muajt e verës, pavarësisht se do të jetë e aksesueshme për turistët gjatë gjithë muajve të vitit.

Gjithashtu mund të ketë edhe ujëra të larjes së ambjenteve të zonës, por që nuk vlerësohen me përberje të elementeve ndotës për mjedisin. Nëpërmjet NJ.Q.V, subjekti duhet të plotësojë kriteret e lidhjes së sistemit të kanalizimeve. NJ.Q.V duhet të ketë projektuar mirë menaxhimin e sistemit të kanalizimeve dhe të furnizimit me ujë të pijshëm për situatën e re. Mirëmbajtja e regjimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore është e rëndësishme për të mbështetur sistemet ekologjike. Prandaj, cilësia dhe sasia e ujit nëntokësor dhe sipërfaqësor janë identifikuar si një Komponent me Vlerë i Ekosistemit (VEC). Një efekt domethënës mjedisor do të rezultonte nëse një ndryshim thelbësor i atribuohet Projektit mund të identifikohet në cilësinë e ujit ose në sasinë në trupat e afërt të ujit ose në ujërat nëntokësore menjëherë në vend, përfshirë pusët më të afërta të banimit.

Punimet e planifikuara në projekt mund të prodhojnë sedimente të imta pezull. Kontrolli i turbulltisë nga sedimentet e imëta është një problem i rëndësishëm që kërkon planifikim të kujdesshëm operacional dhe përdorimin e sistemeve të kontrollit të sedimenteve.

5.3.2 Ujerat nentokesor

Ndikimet e mundshme në aktivitetet e ndërtimit me ndikim në ujërat nentokesore përfshijnë:

- Rritja e pezullimeve në ujërat nëntokësore;
- Rrezik i mundshëm i ndotjes nga karburantet si nafta, mbeturinat e ngurta, etj;
- Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;
- Erozioni dhe sedimentimi;

Ndotja e ujërave nëntokësore nuk pritet. Ujërat që rrjedhin jashtë vendit të ndërtimit të objektit janë ujëra të krijuara nga aktiviteti i lagies së zonës, larja e gomave të automjeteve dhe uji i shiut. Në vendndodhjen e projektit nuk do të ketë depozitim të materialeve të rrezikshme dhe për këtë arsye nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose ujërave sipërfaqësore.

Gjatë ndërtimit, në varësi të reshjeve, një sasi e konsiderueshme e ujit mund të grumbullohet dhe si rezultat, mbledhja e këtyre ujërave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimit mund të jetë e nevojshme, pjesërisht, ato depërtojnë nën tokë. Si pasojë, punimet e ndërtimit nuk duhet të zgjasin dhe të tejkalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit.

Ekziston mundësia për ndotje të ujit nga shkarkimi i mbeturinave të ndryshme të ngurta, në vendin e projektit. Mbetjet e krijuara në zonën e projektit, nëse lihen për një periudhë më të gjatë në tokë / rërë mund të depërtojnë në ujërat nëntokësore duke e kontaminuar atë.


Asnjë substancë e dëmshme nuk duhet të shkarkohet në vend pasi ato mund të depërtohen së bashku me ujërat e reshjeve dhe si pasojë të shkaktojnë ujërat nëntokësore.

Asnjë material i rrezikshëm nuk do të ruhet në vend dhe për rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose ujit sipërfaqësor. Ndotja mund të vijë vetëm nga derdhja e hidrokarbureve ose lubrifikantëve kur furnizohen me mjete të rënda.

5.4 MENAXHIMI I MBETURINAVE DHE NDOTJA E MJEDISIT

Në qytetin e Tiranës rritja e popullsisë dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe ndërtimeve kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e sasisë së mbeturinave urbane dhe të mbetjeve që vijnë nga ndërtimet. Kështu qarku i Tiranës gjeneron 38% të mbeturinave urbane dhe 49% të mbetjeve inerte në Shqipëri. Sasia e mbeturinave të gjeneruara për banorë në cit është 294 kg ndërsa mesatarja në nivel kombëtar është 229 kg/vit.

	Mbeturinat urbane Ton	Mbeturinat inerte Ton	Sasia për banorë Kg
Tirane	327,237	223,718	294
Nivel kombetar	857,223	455,866	229



Duke ju referuar matjeve të bëra nga MMPAU vihet re që nga viti 2006 e në vazhdim gjenerimi i mbeturinave në total ka patur një tendenc rritje në të gjithë vëndin. Kjo gjë është veçanërisht e dukshme në qytetin e Tiranës. Në këtë qytet sasia e mbeturinave është rritur nga viti në vit për shkak të rritjes së popullsisë dhe zhvillimit ekonomik. Ndërsa sasia e mbetjeve inerte ka shënuar një rënie gjatë viteve të fundit.

Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në këtë projekt nuk parashikohet të ketë ndikime në rrjetin ekzistues të furnizimit me ujë të pijshëm apo rrjetin e kanalizimeve. Në rast se punimet zbatohen në mënyrë korrekte, pa shkaktuar aksidente në infrastrukturen ekzistuese.

5.4.1 Impakti mbi tokë

5.4.1.1 Impakti gjatë fazës së ndërtimit

Potencial për ndotje të sipërfaqes së tokës për shkak të rrjedhjeve, pikimeve aksidentale të hidrokarbureve, lubrifikanteve nga pajisje, nga makinerit të cilat operojnë në segmentin gjatë fazës ndërtimore.

Masa parandaluese të rekomanduara për tu zbatuar:

Për të parandaluar kontaminimin e tokës nga ndonjë derdhje, pikim i hidrokarbureve nga makinerit, automjetet gjate manovrimeve, enët që mbajnë kimikate, hidrokarbure, vajra etj, do të pajisen me një kontenier ekstra, e cila vendoset në kontakt me tokën për të shmangur kontaktin e drejtperdrejt të enëve, bidonave me vajra, hidrokarbure apo kimikate të ndryshme me tokën. Një komplet (spill kit) me të gjitha mjetet e nevojshme për të pastruar çdo pikim, rrjedhje aksidentale të mundshme të këtyre kimikateve, do gjendet në gadishmëri në kantier për të vepruar në raste të ndodhjes së një incidenti kontaminimi.

Gjatë fazës operacionale, vënies në funksionim dhe mirëmbajtjes

Nuk pritet të ketë ndikim në cilësinë e tokës pas përfundimit të proceseve.

Shenim: Depozitimi i hidrokarbureve dhe kimikateve është pjesë e Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe përfshin rregullat që duhen të ndiqen për të parandaluar kontaminimin e tokës.

5.4.2 Ndikimi në nivelin e zhurmës

Bezdia e shkaktuar nga zhurma kryesisht prek njerëzit në shtëpitë e tyre, në shkollë ose kur ata janë në rrugë.

Ne vijim paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet:

- E vazhdueshme 1000m nga kompleksi 45 dBA
- E castit 1000 m nga kompleksi 55 dBA
- Nivel maksimal 1m nga pajisja 85 dBA

5.4.3 Ndikimi në sasinë e mbetjeve

Gjate periudhes së ndërtimit pritet një prodhim i vogël i mbeturinave. Pritet gjithashtu, prodhimi i një sasive të vogël edhe të mbeturinave personale të punetoreve dhe personelit.

Llojet, sasitë dhe menyrat e largimit të të gjithë mbeturinave të rendesishme do të shenohen në një regjister dhe për më tepër punetoreve do t'u kërkohej të mbledhin vec fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

Gjithashtu do të krijohen mbetje të cilat do të dalin si pasojë e heqjes së asfaltit të demtuar, krasitjes së kurores së gjelbert etj.

5.4.4 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve

Ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per ndertimin. Ndikimet negative kërkojnë hartimin e masave zbutëse dhe rikuperimet për ndikimet negative dhe kjo realizohet me anë të tre metodave të mundshme:

- evitimi ose parandalimi i ndikimit;
- reduktimi ose korigjimi i ndikimit; dhe
- kompensimi ose shlyerja e ndikimit.

Lloji i rekomanduar i zbutjes së ndikimit ka mundësi të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë zbatueshmërinë teknike, praktikitetin, resurset dhe kapacitetin e disponueshëm, koston dhe nëse rikuperimi i propozuar është konsistent me planin ose programin e propozuar.

6. INFORMACION PË KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA

Për të shmangur në maksimumin e mundshëm ndikimet në mjedis gjatë fazës së ndertimit objekti “Rikualifikimi i bllokut te Tregu Çam” do të ndërmerren këto masa nga ana e kontraktorit:

-Duhet të mirëmbajë shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për vizitorët që janë në zonë gjatë periudhës së ndërtimit.

-Duhet të marrë masa paraprake për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës të punësuarve, të kalimtarëve; si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit, në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

-Duhet të parashikojë grumbullimin dhe nxjerrjen e mbeturinave për në vendin e depozitimit përfshirë dhe ngarkimin në mjetin që do t’i transportojë ato.

-Duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

-*Furnizimi me Materiale:* Kontraktorit do ti kërkohej të përdorë ose të blejë materiale nga furnitoret ekzistues që operojnë me leje mjedisin të vlefshëm dhe licencat e tjera.

-*Aktivitetet e germimit.* Projekti parashikon procese germimi.

-*Transporti i materialeve:* Punonjësve të kamionëve do t’u kërkohej të mbulojnë ose të lagin ngarkesat e kamionëve, tërheqin materialet jo në orët e kulmit të trafikut, dhe të përdorin

rrugë alternative për të minimizuar ngjeshjen e trafikut. Kontraktorit do t'i kërkohej të përgatisë dhe t'i japë mbikqyrësit të punës një plan manaxhimi trafiku që tregon rrugët dhe kohët që mund të përdoren për të shpërndarë materialet në dhe prej vendit të punës.

-Zhurma dhe pluhuri: Kontraktorit të ndërtimit do t'i kërkohej të kufizojë aktivitetet për në orët më ditë (jo ndermjet 23.00 dhe 7.00 ose sipas marrëveshjes me publikun dhe autoritetet) dhe të përdorë pajisjet që largojnë zhurmat.

-Mbeturinat e ngurta dhe sedimentet në drenazhim: Mbeturinat e ngurta të spastruara do të dorëzohen punonjësve të licencuar, me sigurimet e duhura në dokumentat e tyre të kontratës për të kryer inspektim visual për materiale toksike përpara dorëzimit, ndajnë fraksionet e mbeturinave si të jetë e nevojshme, përdorin masat e duhura të sigurisë gjatë mbartjes dhe transportimit të mbeturinave, dhe i hedhin në vendet e autorizuara me aprovimin e autoriteteve lokale.

-Ndotja e ujit: Kontraktorit do t'i kërkohej të organizojë në mënyrë të duhur dhe të mbulojë zonat e grumbullimit të materialeve; izolojë çimenton, asfaltet dhe punë të tjera prej ndonjë rrjedhjeje uji duke përdorur forma pune të izoluara; izolojë zonat e larjes së betonit dhe kamionet e asfaltit dhe pajisjet e tjera nga rrjedha e ujit duke zgjedhur zonat për larje që nuk kanë drenazhim direkt ose indirekt nëpër ndonjë rrjedhje uji. Kontraktori do të sigurojë më tej mbartjen e duhur të lubrifikanteve, karburantit, dhe tretesave duke i ruajtur me siguri; sigurojnë ngarkimin e duhur të karburantit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve; grumbullojnë të gjitha mbeturinat dhe i hedhin në pajisjet e lejuara të mbeturinave.

-Në përfundim të punës Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat dhe të lërë sheshin pastër.

7. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV

Ndikimet potenciale hapësinore të projektit pritet të jenë shumë të kufizuara. Burimet e mundshme të zhurmës dhe që mund të ndikojnë negativisht në mjedis përfshijnë përgatitjet e sheshit të ndërtimit të shtit, si dhe aktivitetet e çmontimit (d.m.th., kamionë, pajisje, etj.). Ndërsa distanca nga sheshi i projektit rritet, nivelet e zhurmës do të zbuten. Sidoqoftë, zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të dëgjohet nga banorët e afërt. Ndërsa të vetmet burime të ndikimit në mjedis jashtë kësaj zone do të jenë kamionët e tonazhit të rëndë gjatë udhëtimit për në objekt që shkaktojnë zhurma dhe vibrime dhe emetojnë sasira tejet të limituara të ndotesve atmosferike.

Siç është vërejtur në seksionet e mësipërme, ku janë marrë parasysh të gjithë elementët mjedisorë që mund të preken nga projekti, ndikimi i projektit do të ketë shtrirje të kufizuar hapësinore:

- Ndikimi në mbulesën bimorë do të jetë i pandjeshëm.
- Gjenerimi i mbetjeve të ndërtimit do të kufizohet vetëm në zonën e projektit.
- Përkeqësim i përkohshëm i pamjes vizuale do të ndodhë vetëm në zonën e projektit dhe ky do të jetë i pjesshëm.
- Gjatë fazës së ndërtimit në zonë priten të regjistrohen nivele relativisht të larta të zhurmës, por këto do të kufizohen brenda zonës së projektit.
- Emetimet e pluhurit do të dalin nga aktivitetet e ndërtimit dhe trafiku i mjeteve të ndërtimit. Emetimet nga aktivitetet e ndërtimit, sidomos me zbatimin e masave mitiguese, do të kenë kufizime përse i përket shtrirjes hapësinore.
- Emetimet e lindura nga trafiku përfshijnë pluhurin dhe tymrat. Kamionët e përdorur për të transportuar materiale të ndryshme ndërtimi nga burimi i tyre për në sheshin e ndërtimit emetojnë gazra të ndryshme si SO₂, CO₂, CO, NO_x dhe grimca. Ndikimet e emetimeve të tilla mund të jenë më të mëdha në vendin e ndërtimit dhe në komunitetet ndërmjet të cilave do të udhëtojnë automjetet e ndërtimit.
- Aktivitetet e planifikuara për projektin kanë ndikim vetëm minimal mbi ujërat nëntokësore, rrjedhjet ujore mbitokësore apo ujërat e zeza. Ky ndikim do të jetë tepër i kufizuar përse i përket shtrirjes hapësinore duke u kufizuar vetëm në zonën e projektit.

8. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

8.1 Mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme

Njohuri të përgjithshme

Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofrojë rekomandime të përshtatshme për rehabilitimin dhe njëherësh mbrojtjen e zonës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të mbrojtjes së cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe të mbrojtjes së cilësisë së tokave në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promovimin publik të gjithë zonës përreth. Plani i rehabilitimit është hartuar në zbatim të "Udhëzimi, Nr.3, datë 17.05.2006 për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga vepra të caktuara". Aty trajtohen të gjitha masat dhe veprimet për sistemin dhe përgatitjen e vendit, për gjelbërimin dhe rigjelbërimin, si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme që sigurojnë mirmbajtjen e habitatit.

Nevojat për rehabilitim

Shfrytëzimi i zonës, si aktivitet ndërtimor sipërfaqësor vepron në sipërfaqe. Pjesa e relievit, ku do të zbatohet aktiviteti, do të transformohet në një sipërfaqe ndërtimi. Nga këqyrja në vend konstatohet se sipërfaqja, ku do të ndërtohet vepra është e ndërtuar dhe është po ashtu një zone me dendësi popullore të lartë. Përpara subjektit dalin detyrime, të cilat duhet të zbatohen mbështetur me fonde financiare të planifikuara që në projekt dhe

me grafik për vazhdimësinë e rehabilitimit të sipërfaqeve të shfrytëzuara dhe rreth tyre, gjatë jetës së veprës dhe mbas saj.

8.2 Masat rehabilituese

Masat rehabilituese në planet e rehabilitimit identifikohen në përputhje me karakteristikat e vlerat e habitatit. Rigjëlberimi i habitatit me bimësi kryhet, duke i dhënë përparësi bimëve autoktone, të përshtatshme me zonën, si dhe bimësisë tjetër që është në përputhje me tipin e tokës.

Kriteret për vlerësimin e rehabilitimit të habitatit përfshijnë:

- a) zona e rehabilituar të rikthehet në një gjendje të qëndrueshme dhe jo ndotëse;
- b) zona të jetë kthyer në gjendje të përshtatshme për përdorimin e mëtejshëm të planifikuar;
- c) zona nuk duhet të preket nga erozioni;
- d) rigjëlberimi të jetë efektiv në të gjithë sipërfaqen e habitatit, duke vlerësuar densitetin e fidanëve, larminë e llojeve dhe mbulesën bimore, siç është parashikuar në planin e miratuar të rehabilitimit.

Sistemimi dhe përgatitja e vendit

Hapi i parë në operacionin e rehabilitimit është pastrimi i përgjithshëm dhe sigurimi i zonës.

Hapi i parë në procesin e përgatitjes përfshin rimodelimin e zonës. Përdorimi përfundimtar i tokës do të përcaktojë formën e relievit. Vendi duhet të modelohet në mënyrë të tillë që të harmonizohet me peisazhin rrethues. Vendi duhet lënë në një gjendje të qëndrueshme, lehtësisht të kulluar që të harmonizohet me zonën rrethuese.

Shtresa e tokës duhet të ripërhapet në mënyrë uniforme mbi zonë në një thellësi të përshtatshme për të mbështetur rigjëlberimin. Në rastin tonë do të mungojë shtresa e tokës, por do të kërkohen alternativa në materiale argjile të pranishme në vende pranë, në mbulesë minerale ose shkëmbinjsh sedimentare që përfshin një përmbajtje të lartë plurur minerali, shkëmb shumë të thërmuar ose shtresë dheu që mund të merret nga vendet e ndërtimit, por duhet përshtatur në ngjyrë pa prishur peisazhin. Të gjitha zonat e ngjeshura duhet të punohen thellë përgjatë konturit. Kjo mund të kryhet përpara ose pas përhapjes së shtesës së dheut.

▪ **Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit**

Masat për rigjenerimin e mjedisit do të konsistojnë në:

- a. kryerjen e të gjitha punimeve të domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit.
- b. krijimin e sipërfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e materialeve dhe të sterileve që vijnë nga kryerja e proceseve të punës, të planifikuara në projektin inxhinierik.
- d. mbjelljen e sipërfaqeve të gjelberuara e mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella, etj.

- **Impakti i priteshme dhe masat zbutese per zhurmat**

Impaktet te cilat do te vijne nga ndertimi i objekteve apo infrastruktures se parashikuar ne planin e studjuar krijon emetim zhurmash ne zone. Masat e parashikuara per evitimin e zhurmave ne mjedis. Propozimi i planit per permiresimin e izolimit ndaj zhurmave te objekteve. Zhurmat qe do te gjenerohen ne mjedisin e kantierit ne fjale, do te vijne kryesisht nga mjetet dhe makinerite, si dhe nga perdorimi i vincave te ndryshem, gjeneratoreve, zhurmat e prodhuara nga vete punonjesit qe do te punojne ne kantier, proceset e ndryshme te ndertimit, hedhjes se betonit, etj. Ne rastet kur niveli i zhurmave i tejkalon normat kufi te zhurmes dhe perben rrezik per punonjesit, atehere do te perdoren masa mbrojtese, ne rastin konkret kufje. Te vetmet vibrime qe mund te gjenerohen, jane ato te derdhjes se themeleve ne vend. Zhurma shkaktohen dhe nga levizja e mjeteve te transportit.

Shoqerite ndertuese aplikojne teknologjine me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritjen e shpenzimeve operative.

- **Evadimi i dherave e mbetjeve te tjera te ndertimit**

Subjekti investitor me shpenzimet e veta do te kryeje evadimin e dherave dhe mbetjeve te tjera te ndertimit qe do te dalin gjate hapjes se gropes se themeleve. Grumbullimi dhe transportimi i dherave do te behet nga firma kontraktore konform kerkesave dhe rregullave mjedisore. Ato do te evadohen brenda dites, per te mos penguar punimet e metejshme e per te mos ndotur mjedisin. Te gjitha mbetjet do te largohen nga nje firme kontraktore e cila eshte e licencuar nga Ministria linjes, Kjo kontrate do te lidhet sapo te merret leja zhvillimore.

Referuar VKM Nr.99, date 18.02.2005 Per miratimin e katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve", mbetjet qe prodhohen klasifikohen me kodet:

20 01 01 Leter dhe karton,

20 01 02 Qelq

20 01 39 Plastiket

20 01 40 Metalet,

20 02 02 Dhera dhe gure

Evadimi ne menyre te vazhdueshme i te gjitha mbeturinave qe do te krijohen gjate Punes.

Mbeturinat e ngurta, me natyre dhe perberje, do te jene mbeturina inerte te tilla si gure, leter, qelq, mbeturina llaci tulle etj. Per grumbullimin e mbeturinave do te mbahen konteniere te vecante brenda rrethimit te objektit dhe me vone do te evadohen brenda dites per te mos penguar.

- **Masat per emetimet ne ajer**

Aktiviteti nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk perdore lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij.

Lenda djegese perdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do te merren keto masa :

1- Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

2- Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike. Perreth linjes do te behet sistemimi i ambjentit per qellim mbrojtjen e peisazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershem. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.

Projekti i ndërtimit është parashikuar të zbatojë të gjitha masat për të reduktuar sa më shumë ndikimet negative në mjedis. Punimet e gërmimit do të kryhen duke bere lagie me ujë të sipërfaqes për të ulur emetimin e grimcave të pluhurit, si dhe vecimin apo menjanimin e të gjitha mbetjeve te ngurta të rezultuara gjatë proceve te gërmimit.

Përdorimi me eficence i makinerive që konsumojnë karburant për të ulur konsumin e panevojshem të lëndës djegëse dhe për rrjedhojë duke ulur dhe sasinë e emetimeve të CO₂, SO₂, NO_x, VOC që emetohen nga djegia e karburantëve. Ndotja potenciale e ajrit si pasojë e operacioneve të ndërtimit vlerësohet të mos i tejkalojë normat e cilësisë së ajrit për qëndrat e banuara që përcaktohen në VKM nr.803 datë 04.12.2003 "Për normat e cilësisë së ajrit". Lagia e rrugëve dhe e zonave të prekura nga ndërtimi, spërkatja me ujë do të përdoret për minimizimin e pluhurit. Spërkatja do të kryhet atëherë kur është e nevojshme, për shembull kur janë kushtet e motit të thatë dhe/ose erëra të forta. Ujërat e përdorur për këtë qëllim duhet të përdoren në sasi të cilat nuk do të rezultojnë në krijimin e rrjedhave. Kufizimi në minimum i disa aktiviteteve sic janë gërmimi dhe lëvizja e makinave gjatë erërave të forta. Reduktimi i shpejtësisë së lëvizjes në një nivel ku ngritja e pluhurave është minimale. Ujitja (me zorrë) e agregatit dhe grumbulli të materialeve gjatë erërave të forta. Grumbulli i dherave duhet të pozicionohet në një mënyrë që nuk është e cënueshme ndaj erozionit të erës. Burimi i ujit të gjithë uji për qëllimin e kontrollit të pluhurit do të nxirret nga burime të vlerësuar dhe aprovuar. Kontraktori do të regjistrojë sasinë e ujit të përdorur. Transportuesit e materialeve të lehta duhet të sigurojnë që operacionet e tyre nuk paraqesin problem nëpërmjet derdhjes së materialit ose krijimit të pluhurave. Ëshë e rekomandueshme që ngarkesa e të gjitha makinave të transportit të jenë të mbuluara me mushama kundra ujit. Të gjithë kamionat ose makineritë që largojnë dherat nga sheshi duhet të kenë kazanët ngarkues të mbuluar me mushama për të parandaluar gurët dhe dherat të bien në sipërfaqet e rrugëve ose të shkaktojnë shqetësime për personat në afërsi. Automjetet nuk lejohen të dalin në rrugët e asfaltura me goma me balte. Ato duhet të pastrohen brenda sheshit të kantierit para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të qytetit. Makinat do të lahen dhe pastrohen brenda kantierit para se të dalin në rrugët e qytetit.

Rigjëlberimi dhe gjëlberimi

Vegetacioni është stabilizuesi më i mirë i mirëmbajtjes së thjeshtë të zonave të degraduara në periudhë afatgjatë. Rigjëlberimi i shërben parandalimit të erozionit. Rigjëlberimi gjithashtu minimizon ndikimin e ndërhyrjes pamore.

Masa të sugjeruara

- Rigjëlberimi do të synojë instalimin e bimëve autoktone. Instalimi i tipeve të vegetacionit jo autokton, mund të kërkojë më shumë burime se riinstalimi i vegetacionit origjinal. Tokat për llojet e huaja duhet të jenë relativisht pjellore dhe mund të jenë të nevojshme trajtimet e mirëmbajtjes, si plehërimi dhe krasitja.

Monitorimi dhe mirëmbajtja - Rehabilitimi është një proces që mund të shkojë me vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetë qëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

Masa të sugjeruara

Zonat e rehabilituara duhet të inspektohen rregullisht për të vlerësuar shëndetin e vegetacionit dhe kontrolluar për erozion, dëmtim nga kullotja dhe ndotje nga barërat e këqija. Inspektime të përvitshme mund të kërkojnë në disa zona më të mëdha pas ndërprerjes së operacioneve për të siguruar suksesin në vazhdim të rigjëlberimit.

8.3 Kostot financiare për rehabilitim

Metodat e rehabilitimit

Mbrojtja e mjedisit është një detyrë që duhet të zgjidhet që në hartimin e projekt zbatimit të aktivitetit. Ky projekt në skemën e tij duhet të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në dëmtues të veprës. Hartimi i projektit të cekët apo me mangësi, zbatimi i punimeve me cilësi të dobët që bëhen burim avarish, janë shkaqet që sjellin pasoja të rënda në mjedis.

Rehabilitimi i ndikimeve

Në rastet kur nuk është identifikuar asnjë masë zbutëse ose kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VPNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose "reziduale". Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN

Plani i Menaxhimit Mjedisor- PMM për punimet e propozuara në zonën e projektit, identifikon aspektet e mundshme mjedisore dhe sociale që duhet të monitorohen. Ai identifikon palët përgjegjëse për monitorimin, shpenzimet e nevojshme, treguesit dhe nevojat për trajnim apo për ngritjen e kapaciteteve dhe raportimin. Në seksionet më poshtë janë përshkruar në mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme të PMM.

9.1 Marreveshjet institucionale: Strukturat dhe përgjegjësitë

Përgjegjësia institucionale për zbatimin e kësaj PMM bie mbi Bashkinë Tirane. Një ndër rolet kyç të bashkisë do të jetë rishikimi i raporteve të konsulentëve për pajtueshmërinë me PMM. Role të tjera do të jenë:

- Monitorimi i zbatimit të veprimeve zbutëse nga kontraktorët
- Koordinimi i trajnimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve, kur janë planifikuar
- Raportimi periodik mbi zbatimin e PMM

Bashkia Tirane duhet të sigurojë që i gjithë personeli i saj i përfshirë në zbatimin e këtij PMM kanë kualifikimin e nevojshëm dhe janë emëruar në bazë të kualifikimit dhe përshtatshmërisë së tyre për rolet përkatëse pasi për ta nuk janë parashikuar trajnime në këtë PMM.

Bashkia Tirane do të kërkojë nga kontraktorët zbatimin e plotë të këtij PMM dhe kontraktorët duhet të caktojnë një specialist Mjedisor i cili do të mbikëqyrë mjedisin gjatë ndërtimit. Megjithatë, në rastin kur kontaktori nuk ka një Specialist Mjedisor, inxhinieri mbikëqyrës apo menaxheri i sheshit të ndërtimit duhet të trajnohet për ceshtjet e mjedisit të rëndësishme për këtë PMM në mënyrë që ai të luajë edhe rolet e mbikëqyrjes së ceshtjeve të mjedisit kur kërkohet. Përveç kësaj Bashkia duhet të caktojë një specialist të sajën për të përfaqësuar objektivat dhe interesat mjedisore të klientit gjatë fazës së ndërtimit. Kriteri bazë i punësimit për një person të tillë është që të ketë një formim në ceshtjet mjedisore, në veçanti të lidhura me projektet e ndërtimit.

Inspektorët e mjedisit nga Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në Tirane janë përgjegjës për mbikëqyrjen e mbrojtjes së mjedisit në emër të AKM. Ata do të kenë edhe rolin e monitoruesit gjatë zbatimit të këtij PMM. Bazuar në njohuritë e tyre profesionale apo rekomandimet në këtë VNM, zyrtarët lokalë të mjedisit mund të kenë rol në hartimin e projektit, si këshilltarë për inxhinieret konsulentë në aspekte të ndryshme.

9.2 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrolloje nëse veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qënë efektiviteti i tyre. Monitorimi do të identifikojë edhe ndikimet e paparashikuara që mund të lindin nga zbatimi i projektit.

Kush monitoron dhe si: Monitorimi do të kryhet nga Bashkia Tirane dhe Inspektorët e Mjedisit të Agjencise Rajonale te Mjedisit (ARM) Tirane që përfaqësojnë AKM. Monitorimi nga ARM-ja në këtë rast mund të konsiderohet si "Monitorim nga një palë e tretë", por ky është mandati i saj rregullator në përputhje me VKM Nr 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale te Mjedisit"

Një agjenci qeveritare që mund të ndërmarrë "Monitorimin nga një palë e tretë" është Inspektorati Shtetëror i Punës. Kjo njësi ka autoritetin për të inspektuar cdo strukturë për zbatimin e ligjshmërisë për sigurinë në vendet e punës.

Monitorimi do të bëhet me anë të inspektimit, shqyrtimit të ankesave të regjistruara nga palët e interesuara dhe diskutime "ad hoc" me persona potencialisht të prekur (punëtorët e ndërtimit, banorët pranë zonës së projektit, etj.).

Frekuenca: Monitorimi do të kryhet çdo muaj gjatë gjithë periudhës së ndërhyrjes.

Auditimet: Auditimet do të jene të nevojshme si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë funksionimit të projektit. Ndërsa auditimet e ndërtimit do të synojnë në verifikimin e përputhshmerise me kërkesat për masat zbutëse të ndikimit, auditimet post-ndërtimit janë një kërkesë ligjore dhe duhet të kryhen si rregull brenda 12 muajve por jo më vonë se 36 muaj pas përfundimit të ndërtimit.

Si auditimi gjatë ndërtimit ashtu dhe ai post-ndërtim mund të jenë të brendshem (kryhen nga Bashkia e Tiranes) ose te jashtëm (nga një konsulent i angazhuar nga Bashkia). Në këtë PMM është propozuar edhe buxheti përkates, nëse auditimi do të kryhet nga një konsulent i punësuar për këtë qellim.

Raportimi: Bashkia duhet të hartojë çdo muaj raporte mbi monitorimin. Këto raporte duhet ndahen me palët e interesuara. Bashkia mund ti ndajë raportet e saj të auditimit gjatë fazës së ndërtimeve dhe post-ndërtimit me AKM apo aktorë të tjerë të interesuar por nuk ka asnjë detyrim ti bëjë të ditur auditimet në fazën e ndërtimit.

9.3 Mekanizmi i zgjidhjes se ankesave

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrolloje nëse veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qënë efektiviteti i tyre. Monitorimi do të identifikojë edhe

Ky seksion përshkruan rrugët që mund te ndjekin personat e prekur për të paraqitur ose shprehur një ankesë kundër këtij projekti, stafit të tij ose kontraktorëve gjatë zbatimit të projektit. Ne kete seksion gjithashtu përshkruhen procedurat, rolet dhe përgjegjësitë për adresimin e ankesave dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Çdo person i dëmtuar mundet të nxise këtë mekanizëm për të zgjidhur shpejt ankesat e tij. Objektivat e procesit të ankimit janë:

- i) Të sigurojë që janë identifikuar dhe zbatuar te gjitha veprimet e duhura korrigjuese reciprokisht të pranueshme për të adresuar ankesat;
- ii) Të verifikojë nese personat qe kane paraqitur ankesat janë të kënaqur me rezultatet e veprimeve korrigjuese;
- iii) Te shmangen perplasjet dhe proceset gjyqësore.

Mekanizmi i menaxhimit/zgjidhjes se ankesave në çdo objekt do të ushqehet nga tre burime kryesore:

- Banorët e zones/komunitetit.
- Inxhinieri mbikëqyrës, përgjegjesi i kantierit ose kontraktori.
- Ekipi monitorues i cili do të përcjellë çështje / probleme të identifikuar në këtë fushë

Hapat e procesit të ankimit janë përshkruar më poshtë. Skema që përshkruan veprimet kryesore gjithashtu është paraqitur me poshtë.

Hapi 1: Pranimi i ankesës

Ankesa verbale apo me shkrim do të merret nga Përgjegjesi i Kantierit dhe do të regjistrohet në librin e ankesave. Në libër do të shenojnë pakënaqësitë, datën e paraqitjes, veprimin e ndërmarrë për të trajtuar ankesën apo arsyen përse ankesa nuk është marrë në konsideratë; informacion i dhënë personit që ka paraqitur ankesën dhe data e mbylljes së ankesës. Ankesat duhet të dorëzohen në çdo kohë direkt në zyrën e Përgjegjesit të Kantierit. Procesi për ankesën jepet më poshtë:

- i) Përgjegjesi i Kantierit pranon ankesën (ankesat) nga ankuesi dhe e regjistron atë në libër.
- ii) Përgjegjesi i Kantierit e lexon ankesën e regjistruar për të konfirmuar çdo detaj i ankesës është dokumentuar.
- iii) Ankuesi nënshkruan në libër për të konfirmuar se ankesa është regjistruar me saktësi.

Hapi 2: Përcaktimi i veprimeve korrigjuese

Nëse sipas mendimit të tij / saj, një ankesë mund të zgjidhet në këtë fazë, Përgjegjesi i Kantierit do të përcaktojë një veprim korrigjues në konsultim me personin e dëmtuar. Në librin e ankesave duhet të regjistrohen veprimet korrigjuese, afati kohor brenda të cilit ata duhet të realizohen dhe pala përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Pas zgjidhjes së ankesës, kjo i behet e ditur ankuesit brenda 5 ditëve. Nëse për zgjidhjen e ankesës nevojitet më shumë kohë kjo do të komunikohet më parë në mënyrë të qartë personit të dëmtuar. Për rastet që nuk janë zgjidhur brenda kohës së përcaktuar, do të ndërmerren hetime të detajuara dhe rezultatet duhet të diskutohen jo më shumë se 1 muaj nga parashtrimi i ankesës.

Hapi 3: Takim me ankuesin

Veprimi i propozuar korrigjues dhe afati kohor në të cilën do të zbatohet ky veprim do të diskutohet me ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës.

Hapi 4: Implementimi i veprimeve korrigjuese


Veprimi korrigjues për të cilin është rënë dakord do të ndërmerret nga projekti ose kontraktori brenda afatit të rënë dakord. Data e përfundimit të veprimit do të regjistrohet në librin e ankesave.

Hapi 5: Verifikimi i veprimeve korrigjuese

Për të verifikuar nëse personi që ka bërë ankesën është i kënaqur me reagimin nga ana e projektit, atij do ti kërkohet që të kthehet, nëse nuk është i kënaqur me veprimet korrigjuese.

Hapi 6: Veprimet nga Bashkia dhe kontraktorët e projektit

Nëse Përgjegjesi i Kantierit nuk mund të zgjidhë ankesën, ai do ta parashtroje atë te Bashkia (dhe kontraktori) përmes inxhinierit mbikëqyrës. Besohet që në këtë nivel mund të zgjidhen të gjitha ankesat e mundshme. Procesi që duhet ndjekur për ankesat është paraqitur mëposhtë.



10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim në mjedisin kufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit dhe as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikon në burimet ujore nderkufitare. Nuk ndikohet çështja e ajrit në kontekstin nderkufitar.

Për këtë kapitull nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ruan me kufirin dhe shtetin fqinj.

11. PERFUNDIME

1. VPNM përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social.
2. VPNM është një proces që zhvillohet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit të projektit.
3. Qëllimi i VPNM nuk është të pengojë zhvillimin ekonomik dhe as të ruajë të pashqetësuar ekosistemet natyrore, por të balancojë faktorët ekonomikë, teknikë dhe ambientat me kostot përkatëse, si dhe të përmirësojë cilësinë e planifikimit dhe të zhvillimit.
4. Zona në studim ndodhet në Tiranë.
5. Objektivi i VPNM, është që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraprak të parametrave gjeologo-litologjikë, të treguesve hidrogeologjikë e hidrologjikë, të kushteve gjeologo-inxhinierike (vetitë fiziko-mekanike), parametrave sizmo-tektonik, morfologjik e geomorfologjik, të bazuara në kriteret standarte shkencore ndërkombëtare, sipas IAEGG, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve të sipërmendur natyrorë në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës etj.
6. Ky studim synon, analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, dhënien e masave zbutëse, si për reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis të objektit.
7. Ligji Nr. 10440 dt. 07.07.2011 "Mbi vlerësimin e impaktit në mjedis" synon një vlerësim të përgjithshëm, të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive që zbatohen, duke parandaluar dhe/ose kufizuar impaktin negativ në mjedis; një proces të hapur vlerësimi, të kryer në mënyrë të pa anëshme ndërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jo fitimprurëse, sponsorëve të projektit dhe personave të specializuar në këtë fushë.
8. Në periudhën 1976-2015, veprimtaria sizmike për këtë zonë, mbetet në nivelin e mikro tërmeteve dhe të tërmeteve të vegjël dhe magnituda maksimale nuk e kalon $ML=4.5$. Gjithsesi, është për t'u përmendur që në afërsi të zonës që studiohet, nga viti 1976 e këtej, kanë epiqendrat e tyre disa tërmete dëmtues.
9. Përgjithësisht thellësia e vatrave të tërmeteve në këtë zonë, shkon nga 15-20 deri 25km. Në pikëpamje gjeologjike kjo zonë është në rindërtim të planit struktural dhe përshkohet nga shkëputje tektonike aktive edhe në ditët e sotme.
10. Një lidhje e ngushtë ekziston midis tërmeteve dhe shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive, që herë pas here gjenerojnë tërmete.
11. Perioda e përsëritjes për lëkundjet e forta për zonën e Tiranës është $T_r = 150 - 200$ vjet, d.m.th. lëkundjet 8 ballëshe (ose $PGA = 0.2g$) nuk tejkalohen për kohën $T = 80$ vjet, me probabilitet 70%).
12. Është e njohur që depozitimet e rërave të ngopura me ujë nën veprimin e ngarkesave dinamike ciklike, siç mund të jenë edhe tërmetet, për hir të rritjes së presionit të poreve dhe zvogëlimit të sforcimeve tangenciale midis kokrrizave transformohet në një farë "lëngu", dukuri e cila njihet me emrin "Lëngëzimi i rërave".
13. Rezultate tregojnë se për largësi nga vatra deri 20km, vlerat e PGA (g) luhaten nga

- 0.29-0.42g, vlera shumë të favorshme për zhvillimin e lëngëzimit.
14. Mbështetur në kriteret gjeologjik, si zona me potencial të lartë lëngëzimi vlerësohen depozitimet aluviale në sipërfaqe të rrafshta, në delta, grykë derdhjet e lumenjve, në konet e derdhjes të mbushura me ujë, si dhe mbushjet artificiale. Nga kjo pikëpamje, zona jonë mund të konsiderohet si zone me potencial jo të lartë lëngëzimi të rërave.
 15. Në rajonin të studiuar, përhapje më të madhe midis shkëmbinjve molasike dhe me vlerë më të madhe praktike për furnizim me ujë të rajonit kanë ujërat nëntokësore, që lidhen me konglomeratët dhe ranorët e Kuarternarit. Ata formojnë horizonte ujëmbajtëse me trashësi 5-20m, të ndara midis tyre prej shtresave suargjilore me trashësi disa metrash dhe japin ujë me debit të vogël të rendit 0.1-0.8 l/s (më të shpeshta ato me $Q = 0.3$ l/s).
 16. Ndryshimet në thellësinë e ujit në zona të veçanta varet si nga kontrolli eustatik global dhe ai lokal. Thellësia e ujit përfshin integrimin e furnizimit me sediment – me eustazinë dhe tektonikën.
 17. Duke u nisur nga kushtet gjeografike të zonës, kjo zonë nuk karakterizohet nga shpejtësi të mëdha ere. Mbizotërojnë erërat lindore e juglindore. Në rajon ndihen mirë dhe erërat e nxehta e të thata, që kanë rastisje jo të vogël.
 18. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 16.7°C , duke patur një variacion mujor që ndryshon nga temperatura 7.0°C në janar, që është edhe muaji më i ftohte i vitit deri në 32.0°C në korrik që është muaji më i nxehtë. Temperatura minimale e ajrit me probabilitet $p=1\%$ siguri është $t_{\min}=11.0^{\circ}\text{C}$, ndërsa temperatura maksimale $t_{\max}=40.5^{\circ}\text{C}$.
 19. Ndryshimet për një periudhë shumëvjeçare variojnë brenda kufijve të gjerë, përkatësisht nga 19.5 10^9m^3 për vitin e thatë ($P=99\%$) në 73.109m^3 për atë të lagët ($P=1\%$). Ka dy periudha karakteristike, përse i përket rrjedhjes ujore: periudha e lagët (tetor – maj) dhe periudha e thatë (qershor - shtator). Përkatësisht, shpërndarja është si më poshtë 39% i përket dimrit, 33% pranverës, 17% vjeshtës dhe 11% verës.
 20. Ndër vitet ujëpakët, më i thati paraqitet viti hidrologjik 1949. Koefficienti modular është 0.63 dhe ndryshon nga 0.49 deri në 1.23 d.m.th. sasia e reshjeve ka qenë nga dy herë më pak se mesatarja deri 1.2 herë mbi mesataren.
 21. Edhe pse është e paevitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që të ketë punësim të vazhdueshëm; të krijojë të ardhura financiare dhe ekonomike në zonë; ndikimet mjedisore që janë identifikuar të eliminohen, reduktohen ose zbuten nëpërmjet zbatimit të planit të menaxhimit të mjedisit.
 22. Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë "ndikim fatal", ndonëse ekzistojnë disa ndikime jo të vogla negative, të cilat do të kontrollohen nga masat zbutëse inxhinierike dhe nga ato të lidhura me sheshin.
Dhe për më tepër, plani i menaxhimit të mjedisit do të ndihmojë kompaninë investuese për të arritur një përmirësim të vazhdueshëm të mjedisit gjatë gjithë jetë gjatësisë së aktivitetit të objektit.
 23. Në rajonin tonë, rezultojnë disa zona apo sektorë të ndotur si: damp-a e hapur e shkarkimeve dhe djegies së mbetjeve urbane të rajonit; Kanali i ujërave të shkarkimit; Fushat me produkte bujqësore për shkak të përdorimit në sasi të larta të plehërimit me pesticide; Zona ose sektorë pranë veprave të vogla industriale si: prodhim mermerësh, gurësh dekorativë, etj., që gjenerojnë mbetje inerte;
 24. Ndikimi më i madh do të jetë në trafikun tokësor, në formimin e pluhurit, zhurmës,

- që do të vijnë nga transportimi i materialeve gurore për ndërtimin. Duke marrë parasysh sasinë e materialeve inerte që do të transportohet dhe kohëzgjatjen e furnizimit, ndikimi i kësaj çështje konsiderohet "i lartë". Zbutja e nevojshme e ndikimit të këtij procesi transport dhe depozitim, sheshim, nivelim, hyn në kategorinë e "Praktikave më të mira të Menaxhimit të Zonave të ndërtimit"
25. Ndikimi në burimet kulturore dhe arkeologjike që rrjedh nga operacionet e germimit dhe depozitimit nuk pritet që të ndodhë. Nuk ka vende arkeologjike dhe kulturore, qoftë në vendin e dragimit, ashtu dhe në atë të depozitimit apo reklamimit të tokës.
 26. Ndikimet negative të ndërtimit dhe të hedhjes së materialit të ngarkuar kanë të bëjnë në ndërthurjen e transportit të materialit inerte për mbushje me trafikun ekzistues tokësor, që për fatin e mirë në zonë nuk është shumë intensive, si dhe ndotjen e zhurmës gjatë punës së pajisjeve punuese.
 27. Lëvizja e automjeteve e përqëndruar në një interval dite kohor janë një burim zhurme, por me kohëzgjatje të rendit të milisekondave. Nivelet e zhurmës së krijuar nga lëvizja e automjeteve me llogari teorike mbërijnë në fshat me vlera rreth 40-50 dB(a), por jo më të mëdha.
 28. Të gjitha çështjet e planit zbutës duhet të konsiderohen si praktika të mira inxhinerike dhe praktikatat më të mira të menaxhimit. Masat për kontrollin gjatë fazës së operimit janë përshkruar në tabelën përkatëse, ku përfshihet: Minimizimi i ngarkesës, Permbajtja, Rekuperimi/Riciklimi dhe Trajtimi dhe largimi i mbeturinave.
 29. Operatori do të përgatis planet e caktuar të sigurisë, që duhet të përfshijnë: Plani e evakuimit të njerëzve në rast alarmi; Proçedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik; Proçedurat e mjekimit dhe të ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë; Emrat e personave të kontaktit dhe numrat e tyre të telefonit; Proçedurat e nënshtrimit apo të fikjes së zjarrit.
 30. Ndër skenaret e aksidentëve të mundshme do të jenë: Humbjet si rezultat i ngjarjeve të pa parashikueshme; Dëmet nga ngarkesat dhe aksidentet me vinç; Përplasjet e mjeteve në zonën e ndërtimit dhe Mjetet zjarrfikëse;
 31. Në këtë veprimtari që kryhet në marëdhënie me mjedisin, është parashikuar në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.
 32. Monitorimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre duke ofruar rekomandimet e përshtatshme për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe fokusohet në aktivitetet e këtij objekti, në faktorët që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre.
 33. Për kryerjen e operacioneve të pastrimit janë përcaktuar masa si: mobilizimi i paisjeve të nevojshme, si dhe i fuqisë punëtore; organizim logjistikor të mjaftueshëm për të mos pasur asnjë boshllëk në furnizime si, veshje dhe konsume të tjera; përzgjedhja e mënyrës së përshtatshme për pastrim, rishikimi i vazhdueshëm i proceseve të pastrimit, mbajtja e regjistrave çdo ditë për çdo operacion pastrimi në çdo zonë.
 34. Ndonëse dihet që punimet e ndërtimit çlirojnë ndotësa të mjedisit, ndikimet pritet të jenë minimale, sepse sheshi i propozuar i projektit nuk përmban struktura

ekzistuese. Edhe puna për një nivelim të tij do të jetë mjaft i kufizuar për shkak të vetë gjendjes natyrore të vendndodhjes së sheshit.

35. Mjetet që do të përdoren në ndërtim do të mirëmbahen rregullisht gjë që do të sjellë si pasojë djegie të mirë të karburantit dhe të materialet pluhurore, si PM10 dhe PM2.5.
36. Numri i mjeteve të transportit të mallrave apo edhe i punëtorëve do të jetë i ulët dhe për rrjedhojë ato nuk do të krijojnë ndikim të ndjeshëm negativ.
37. Përsa i përket përhapjes së pluhurit nga rrugët dhe sheshi i ndërtimit mund të eliminohen apo minimzohen duke aplikuar masat e duhura zbutëse, efektet e të cilave janë vlerësuar në bazë të vlerave të raportuara në tabelat pëkatëse.